



## **Decentralizimi dhe Privatizimi i Sektorit te Ujit ne Shqiperi**



Co-Plan

Sabine Beddies

Hermine De Soto

Arben Bakllamja

Xavier Chauvot de Beauchene

Banka Boterore dhe Programi i Zhvillimit te Kombeve te  
Bashkuara, Tirane, Shqiperi

Dhjetor 2004

# Permbajtja

Falenderime.....	iv
Shkurtime.....	v
Fjalor i Termave.....	vi
<b>HYRJE.....</b>	<b>1</b>
Permbledhje e Gjetjeve Kryesore .....	1
Konkluzione dhe Rekomandime.....	5
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>14</b>
<b>KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT E REFORMES NE SEKTORIN E UJIT</b>	
.....	16
Historiku i Reformes ne Sektorin e Ujit ne Shqiperi .....	16
Struktura Institucionale e Sektorit te Ujit dhe Palet e Interesuara ne Reforme .....	18
Varferia ne Shqiperi ne Kontekstin e Reformes ne Sektorin e Ujit.....	21
<b>PROFILET E QYTETEVE .....</b>	<b>23</b>
<b>GJETJE DHE ANALIZA .....</b>	<b>27</b>
Analiza e Ndikimeve.....	27
Rritja e Tarifave .....	27
Aksesi ne Sherbimet e Ujit dhe Kanalizimeve .....	33
Mbeshtetja per Shtresat e Varfera Nepermjet Sherbimeve te Ndhimes .....	41
Ndikimi i Reformes ne Sektorin e Ujit mbi Punesimin .....	44
Kanale te Tjera te Ndikimit te Reformes .....	46
Palet e Interesuara dhe Ceshtjet Institucionale .....	48
Palet e Interesuara dhe Mjedisi i Ri Institucional .....	48
Ceshtjet Kryesore qe Kane te Bejne me Palet e Interesuara.....	49
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PER POLITIKAT .....</b>	<b>52</b>
Ngjashmerite.....	52
Ndryshimet.....	52
Rekomandime per Politikat.....	53
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>58</b>

## Shtojcat

Shtojca 1. Metodologjia .....	56
Shtojca 2. Varferia ne Shqiperi .....	59
Shtojca 3. Kuadri Ligjor ne Mbeshtetje te Reformes. ....	61
Shtojca 4. Profilet e Qyteteve .....	64
Shtojca 5. Raport mbi Intervistat me Informatoret Kyc te Qeverise Qendrore .....	75
Shtojca 6. Raport mbi Intervistat me Informatoret Kyc ne Tete Qytetet e Studimit	88
Shtojca 7. Raport mbi diskutimet e Grupit te Fokusi ne Tete Qytetet e Studimit ....	121
Shtojca 8. Tabela dhe Statistika Pershkruese te Marra nga Pyetesoret Familjare ...	180
Shtojca 9. Raporti Perfundimtar i Ecurise .....	186
Shtojca 10. Pyetesore Familjare Socialo-Ekonomik.....	196
Shtojca 11. Termat e References per Konsulentet Vendore .....	215
Shtojca 12. Tabela e Treguesve Baze .....	221

## Lista of Tabelave

Tabela 1. Matrica AVNS per Decentralizimin dhe Privatizimin e Reformes ne Sektorin e Ujit ne Shqiperi.....	7
Tabela 2. Kushtet dhe Aksesit ne Infrastrukturen e Ujit dhe Kanalizimeve ne Tete Qytetet e Studimit .....	25
Tabela 3. Arsyet e Raportuara per Mospagimin e Faturave te Ujit .....	31
Tabela 4. Nivelet Aktuale te Lidhjes se Ujit dhe te Sherbimeve te Kanalizimeve ...	34
Tabela 5. Shperndarja e Varferise per te Dy Grupet e Qyteteve .....	41

## Lista e Figurave

Figure 1: Harta Institucionale e Struktures se Qeverisjes ne Sektorin e Ujit.....	21
Figure 2. Mendimi i Familjareve mbi Menyren me te Mire per te Permiresuar Detyrimin .....	30
Figure 3. Perqindja e Konsumatoreve me Kontrate te Cilet nuk Jane Pagues te Rregullt.....	33
Figure 4. Sasia e Oreve Mesatare te Furnizimit me Uje per Qytetet (Furnizimi ne Vere kundrejt Dimrit).....	37
Figure 5. Mendimi i Grupe te Varfera te Ndryshme mbi Tarifen e Ndhimes (ne qytetet MP) .....	44
Figure 6. Mendimi i Familjeve mbi Ndikimin e Reformes ne Punesim .....	46
Figure 7. Mendimi i Familjeve mbi Ndikimin e Reformes ne Shendet.....	47

## Lista of Kutive

Box 5.1. Lidhjet midis Aksesit, Vendndodhjes dhe Varferise.....	40
Box 6.1. Nje Rast Ilustrues nga Korca.....	57

## Falenderime

Studimi u krye me ndihmen e shume individeve, institucioneve dhe organizatave, te cilet ofruan nje ndihme te dukshem per studimin. Do te donim te falenderonim Andreas Rohde, Inxhinjer i Larte per Kanalizimet dhe Menaxher i Projektit per Ujin dhe Kanalizimet ne Shkalle Bashkie ne Shqiperi, per mbeshtetjen e tij energjike dhe per kontributin gjate gjithë studimit. Qe ne fillim, ai e kuptoi rendesine e berjes se nje analize per varferine dhe ndikimin social (AVNS) per nje kuptim me te mire te ndikimeve te reformes ne sektorin e ujit ne Shqiperi mbi konsumatoret, sidomos mbi shtresat e varfera dhe grupet e prekshme.

Falenderimet tona te vecanta i drejtohen Programit te Zhvillimit te Kombeve te Bashkuara (UNDP) ne Tirane, vecanerisht Anna Stjarnerklint, Elzira Sagynbaeva, dhe Eno Ngjeles, per zemergeresine e tyre te madhe financiare, pasi ky studim do te kishte qene shume me i paplote pa mbeshtetjen e tyre.

Studimi ne terren u koordinua nga grupi vendor i studimit, Co-PLAN: Instituti per Zhvillimin e Habitatit, Tirane. Ne i jemi mirenjohes vecanerisht, Dritan Shutines, Sotir Dhamos, Jorida Ciles, dhe Nevila Comos, te cilet bene kerkime te palodhura ne terren dhe shkruan te dhenat.

Ne gjithashtu do te donim te falenderonim perfaqesuesit e qeverise qendrore te cilet me dashamiresi na dhane kohen dhe mbeshtetjen e tyre, vecanerisht ne Ministrine e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, Ministrine e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministrine e Ekonomise dhe Ministrine e Financave. Ne i jemi shume mirenjohes te tete bashkive dhe vecanerisht kryetareve te bashkive, zevendes kryetareve te bashkive dhe zyrtareve te tjere te pushtetit vendor ne Drejtorite e Ndhimes Sociale, Shendetit Publik, Puneve Publike dhe Njesive Juridike. Mirenjohje e sinqerte i drejtohet dhe perfaqesuesve te Njesise se Monitorimit te Kontrates, Berlin Wasser, Shoqates Shqiptare te Ndermarrjeve te Ujit dhe Kanalizimeve, Komitetit Ekzekutiv, Keshillit Mbikqyres, Kujdesit Shendetesor Paresor, Agjensise Kombetare te Privatizimit (dega e Sarandes), Dhomes se Tregetise dhe Industrise, Shoqerise Civile, dhe bizneseve te ndryshme. Pa kohen dhe ekspertizen e tyre ky studim nuk do te ishte realizuar.

Ne gjithashtu i shprehim mirenjohjen te gjithë konsumatoreve, individe dhe familjeve, te cilat moren pjese ne anketim, dhe atyre te cilet moren pjese ne diskutimet e grupeve te fokusit. Pa mendimet e tyre, perceptimet e tyre, dhe opinionet e tyre, ky studim nuk do te kishte mundur ta kuptonte varferine dhe ndikimet sociale te reformes ne sektorin e ujit.

## Shkurtime

SHNUK	Shoqata e Ndermarrjeve te Ujit dhe Kanalizimeve ne Shqiperi
SNV	Strategjia e Ndhimes per Vendin
QQ	Qeveria Qendrore
KM	Keshilli i Ministrave
NJMK	Njesia e Monitorimit te Kontrates
KE	Komiteti Ekzekutiv
GF	Grup Fokusi
QSH	Qeveria Shqiptare
GDP	Prodhimi Vendas Bruto
DPUK	Drejtoria e Pergjithshme e Ujrave dhe Kanalizimeve
GTZ	Bashkepunimi Gjerman per Zhvillim
PF	Pyetesor Familjar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KESH	Korporata Kombetare Energjitike e Shqiperise
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Bashkepunimi Gjerman)
PV	Pushteti Vendor
ML	Ministrite e Linjes
SMSJ	Studimi i Matjes se Standarteve te Jeteses
KM	Kontrata e Menaxhimit
OZHM	Objektivat e Zhvillimit per Mijevjecarin
ME	Ministria e Ekonomise
MF	Ministria e Financave
MDPV	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
MRRTT	Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit
KSHAGJ	Kuadri i Shpenzimeve Afat-Gjata
PUKB	Projekti i Ujrave dhe Kanalizimeve [Ujrave te Zeza] ne Bashki
SKDPPV	Strategjia Kombetare per Decentralizim dhe Pavaresi te Pushtetit Vendor
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
SKZHES	Strategjia Kombetare per Zhvillim Ekonomik dhe Social (DSUV ne Shqiperi)
SKUK	Strategjia Kombetare e Ujit dhe Kanalizimeve
OFPV	Ligji mbi "Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Vendor"
O&M	Operim dhe Mirembajtje
OP	Operator Privat
AVNS	Analiza e Varferise dhe Ndikimit Social
DSUV	Dokumenti i Strategjise per Uljen e Varferise
PSP	Pjesemarrja e Sektorit Privat
VQV	Varferia ne Shqiperi: Nje Vleresim Kualitativ
ARZH	Agjensia Rajonale e Zhvillimit
KM	Keshilli Mbikqyres
TR	Termet e References (per konsulentet vendor)
DA	Dollar Amerikan (\$)
BB	Banka Boterore
NU	Ndermarrja e Ujit
ERRU	Entiteti Rregullator i Ujit
PREFU	Projekti per Rehabilitimin Emergjent te Furnizimit me Uje

## **FJALOR I TERMAVE**

**Komune:** Nje njesi vendore, rurale, territoriale dhe administrative qe drejtohet nga nje shef, i cili zgjidhet per nje mandat 3-vjecar nga banoret e kesaj njesie administrative

**MSH:** Kater qytetet ne te cilat ndermarrjet e ujit jane nen menaxhim shteteror

**Meter Kub:** Njesia matese e volumit qe eshte e barabarte me 1,000 litra

**Lek:** Monedha shqiptare (ne kohen e studimit, kursi i kembimit ishte 1 Dollare Amerikan = 121 Lek)

**Ministri e Linjes:** Nje ministri e cila eshte pergjegjese per nje apo me shume aspekte te reformes ne sektorin e ujit persa i perket decentralizimit te funksioneve te sektorit te ujit dhe te transferimit te kompetencave tek pushteti vendor (ketu perfshihen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit, dhe Ministria e Ekonomise)

**MP:** Kater qytetet qe perfituan nga Kontrata e Menaxhimit te Bankes Boterore, ne te cilat ndermarrjet e ujit jane nen menaxhim privat

**Bashki:** Njesi administrative urbane me nje popullsi mbi 4,000 banore dhe qe ka nje zhvillim industrial

**Cilesi sherbimi:** Kjo ka te beje me “oret e furnizimit me uje” dhe “presionin e ujit”

**Ndihme ekonomike nga shteti:** Nje program i qeverise shqiptare, i cili ofron ndihme monetare per familjet pa te ardhura alternative

**Vendbanime te reja:** Vendbanime te krijuara pas 1990 perreth zonave urbane, te cilat ne kushte normale nuk kane akses ne infrastrukturen baze

**Rajon:** Nje njesi vendore, territoriale dhe administrative e cila perbehet nga me shume se nje bashki dhe disa komuna

**Qytete te studiuara:** Te tete qytetet e studiuara te marra se bashku

# HYRJE

Ky studim perben nje analize te varferise dhe ndikimit social (AVNS) te reformes ne sektorin e ujit ne Shqiperi. Ky studim i vjen ne ndihme zbatimit te Strategjise Kombetare per Zhvillim Ekonomik dhe Social ne Shqiperi (SKZHES), si dhe refomes se saj ne sektorin e ujit. Reforma ne Sektorin e Ujit dhe Kanalizimeve konsiderohet si nje komponent i rendesishem i SKZHES. Refoma synon te permiresoje aksesin ne sherbimet e ujit dhe kanalizimeve, persa i perket zones se shtrirjes, sasise dhe cilesise te furnizimit me uje. Gjithesesi, pritet qe reforma te kete po ashtu dhe efekte negative sociale, sidomos persa i perket ndikimit te saj mbi grupet me te prekshme te shoqerise, te tilla si shtresat e varfera qe jetojne ne zonat urbane. Reforma ka per qellim gjithashtu te nxise nje menaxhim te qendrueshem te ujit dhe realizueshmeri financiare te ndermarrjeve te ujit.

Ky dokument prezanton rezultatet dhe analizat e nje studimi kerkimor, sasior dhe cilesor, objektivat e te cilit jane tre:

1. Te vendose kritere per te vleresuar perceptimin dhe masen e permbushjen se deshirave te paleve te interesuara ne lidhje me dy modelet e menaxhimit te shperndarjes se sherbimeve te ujrave, dhe te mase ndikimet e shperndarjes se reformes ne sektorin e ujit dhe te kanalizimeve mbi mireqenien e paleve te interesuara kundrejt ketyre kritereve, vecanerisht mbi shtresat e varfera ne zona urbane, ne lidhje me:

- Rritjen e tarifave
- Sherbimet e furnizimit me uje dhe kanalizimeve nepermjet furnizuesve private dhe publike
- Mbeshtetjen per shtresat e varfera nepermjet nje ndihme prej 20 litra per person ne dite pa pagese
- Ndryshimet ne masen e punesimit per grupet e ndryshme
- Ndikimet e tjera qe mund te sjelle reforma

2. Te identifikoje dhe te ofroje informacion te detajuar mbi disa nga ceshtjet kryesore institucionale dhe problemet e reformes ne sektorin e ujit. Per te arritur kete objektiv, eshte menduar te behet nje analize e procesit te decentralizimit, duke nxjerre ne pah ndikimet negative dhe pozitive te te dy modeleve te menaxhimit te sektorit te ujit.

3. Te paraqese rekomandime per te intensifikuar hapat dhe qendrueshmerine e reformes, si dhe rekomandime per zbutjen e ndikimeve te padeshiruara mbi grupet e prekshme te shoqerise.

## **Permbledhje e Gjetjeve Kryesore**

*Karakteristika te pergjithshme te qyteteve te perzgjedhura*

- Te gjitha qytetet e perzgjedhura, pervec Korces, shfaqin karakteristika te ngjashme persa i perket siperfaqes se mbulimit, sistemeve te faturimit, raportit te mbledhjes se pagesave dhe niveleve te humbjeve te ujit.
- Qytetet e projektit ndryshojne nga njeri-tjetri ne llojin e menaxhimit te ndermarrjeve te ujit, prezences se lidhjeve te paligjshme, numrit te popullise si rezultat i tendencave te urbanizimit gjate 13 vjeteve te fundit, si dhe mundesive te tregut te punes.

#### *Rritja e tarifave*

- Klauzola per te transferuar autoritetin e percaktimit te tarifave te ujit tek pushteti vendor (PV) nuk eshte pritur pozitivisht nga Rrjeti Rregullator i Ujit (RRU).
- Rritja e tarifave po ndikon negativisht mbi kategorite me te prekshme te popullise, te tilla si popullsia urbane. Perfshirja e tarifave se ndihmes (20 litra per person ne dite) ne kontraten e menaxhimit, po e lehteson kete ndikim ne kater vendbanimet e perfshira ne studim (MP), te cilat perfitojne nga Kontrata e Menaxhimit e Bankes Boterore dhe ku ndermarrjet e ujrave jane nen menaxhim privat.
- Pamundesia per te paguar eshte nje problem kryesor nder familjet tejet te varfera, familjet e pensionisteve dhe familjet qe jetojne ne vendbanimet e reja.
- Nderkohe qe “mungesa e mjeteve financiare” eshte arsyeja e permendur me shpesh per mospagesat nder grupet e “me te varferve” dhe “te varferve”, “pakenaqesia ndaj sherbimeve” eshte raportuar si arsyeja kryesore per mospagesat nder familjet jo dhe aq te varfera.
- Konsumatoret nuk i mirepresin rritjet e tarifave, vecanerisht kur ato nuk shoqerohen nga permiresime ne sherbime.
- Edhe familjet ne gjendje financiare relativisht te mire, nuk e mirepresin koston e larte te instalimit te aparateve mates.

#### *Lidhjet me sherbimet e furnizimit me uje dhe kanalizimeve*

- Perqindja e familjeve qe kane lidhje uji (82 perqind e te anketuarve ne kater qytetet me kontrate menaxhimi privat (MP), dhe 99 perqind e te anketuarve ne kater qytetet me kontrate menaxhimi shtetror (MSH)) eshte me e larte se e atyre qe raportojne te kene akses ne kanalizime (64.5 perqind e familjeve ne kater qytetet me kontrate menaxhimi privat dhe 84.3 perqind e familjeve ne qytetet qe jane te menaxhuara nga shtetit).
- Lidhjet ne te dy sherbimet jane me te larta ne qytetet MSH. Migracioni i larte i

dukshem drejt qyteteve MP krahasuar me qytetet MSH eshte arsyeja per nivelet e ndryshme te aksesit.

- Cilesia e sherbimit, qe nenkupton “oret e furnizimit me uje” dhe “presionin e ujit”, mund te konsiderohet disi me e larte ne qytetet MP per shkak te nje nderhyrjeje te Projektit te Riaftesimit Emergjent [te Menjehershem] te Furnizimit me Uje (PREFU).
- Cilesia e sherbimit te ujit dhe te sistemit te kanalizimeve varet nga distanca e vendbanimeve nga qendra urbane (kjo do te thote, sa me afer qendres urbane te jene vendbanimet, aq me e larte eshte cilesia e furnizimit me uje)
- Menyra me e perdorur per perballimin e furnizimit te pamjaftueshem me uje eshte nepermejt nderhyrjeje te paligjshme ne tubacionet kryesore te ujit. Mekanizma te tjere per perballimin perfshijne: (a) hapjen e puseve ne oborre, (b) blerjen e rezervuareve personale te ujit, (c) blerjen e pompave te ujit, (d) blerjen e ujit ne dyqane, dhe (e) vendosjen e lidhjeve shtese. Rezervuaret septike jane zgjidhja me e perdorur per perballimin e problemeve me ujrat e zeza, vecanerisht ne qytetet MP.
- Familjet me te varfera paraqesin nje numer me te larte lidhjesh te jashteligjshme, krahasuar me familjet ne gjendje me te mire ekonomike.
- Familjet tejet te varfera dhe familjet e varfera jane me te pafavorizuara persa i perket mbulimit nga rrjeti dhe cilesise se sherbimit (rreth 28 perqind e familjeve tejet te varfera dhe rreth 17 perqind e familjeve te varfera nuk kane asnje lidhje me tubacionet e furnizimit me uje).

#### *Mbeshtetja e familjeve te varfera me sherbime nepermjet ndihmes*

- Megjithese fatura e ujit perben vetem nje fraksion te vogel te shpenzimeve mujore te familjeve, ka familje te cilat nuk mund ta paguajne kete sherbim. Kjo kategori perbehet kryesisht nga familje qe perfitojne ndihme ekonomike nga shtetit te tilla si: familjet e pensionisteve dhe familjet qe jetojne ne vendbanimet e reja.
- Opinionet e eksperteve dhe konsumatoreve jane te ndryshme ne lidhje me tarifat e ndihmes. Disa besojne se tarifa e ndihmes eshte nje forme e pershtatshme subvencioni, kurse te tjere sugjerojne forma subvencioni, te tilla si rritja e mases se ndihmes ekonomike nga shteti per familjet ne nevojte, ose dhenia e subvencioneve direkte ndermarrjeve te ujit (NU) per te mbuluar koston e faturave te papaguara te ujit nga familjet nevojtare.

#### *Kanale te tjera te ndikimit mbi reformen*

- *Punesimi:*
  - Lidhja ndermjet furnizimit me uje dhe mases se punesimit eshte specifike per cdo qytet, dhe varet nga vecorite e tregut te punes. Reforma mendohet te ndikojte ne menyre pozitive mbi industrine ushqimore, sektorin e sherbimeve dhe sektorin e turizmit, vecanerisht ne qytetet bregdetare.
  - Furnizimi me i mire me uje do te lehtesoje grate, duke iu dhene atyre mundesi te kerkojne punesim jashte shtepise.
  - Shpesh here eshte e veshtire per njerezit te kuptojne se si sherbimet e permiresuara te ujit dhe te kanalizimeve mund te ndikojne ne punesim.
  - Ristrukturimi i ndermarrjeve te ujit te menaxhuara privatisht do te sjelle humbjen e vendeve te punes per disa nga punonjesit, duke rritur keshtu kundershkrimin dhe pakenaqesine.
- *Shendetesia:* Here pas here qytetaret mendojne se infrastruktura e vjeteruar e kanalizimeve eshte nje burim semundjesh akoma edhe me i rrezikshem se cilesia e ulet dhe e pamjaftueshme e ujit. Raste te semundjeve te shkaktuara nga uji apo qe kane lidhje me ujin jane pare kryesisht ne qytetet e Durresit dhe Gjirokastrës.
- *Kursimet:* Konsumatorët nuk kane raportuar ndonje ndikim te dukshem te reformes mbi kursimet familjare. Kjo mund te vije kryesisht per shkak te influences relativisht te ulet te fatures se ujit mbi shpenzimet mujore te familjeve. Shpenzimet shtese per blerjen e rezervuareve familjare dhe pompave te ujit si dhe kostoja shtese e konsumit te energjise elektrike per funksionimin e pompave te ujit, jane te gjitha shpenzime jo lehtesisht te dukshme qe kane te bejne me furnizimin me uje.
- *Toka:* Vetem nje numer i vogel ekspertesh e permenden ndikimin e ujit mbi token si nje aset qe ka vlere.

#### *Palet e interesuara dhe ndikimi institucional*

- Palet e interesuara ne reforme ndahen ne tre grupe: (a) ata qe ndikojne mbi reformen ose e zbatojne reformen; (b) ata qe preken nga reforma, ne menyre pozitive apo negative; dhe (c) ata qe ndikojne mbi politikat e reformes.
- Duke qene se roli i qeverise qendrore po ndryshon nga ofrues sherbimi ne rregullator dhe lehtesues, marredhenie te reja institucionale po krijohen ndermjet paleve te interesuara. Kjo eshte vecanerisht e dukshme ne kater qytetet MP, ku dy mekanizma shtese luajne nje rol te rendesishem: Komiteti Ekzekutiv (KE) dhe Njësia e Monitorimit te Kontrates (NJMK).

- Palet e interesuara shpesh nuk kane informacionin e duhur mbi rolin dhe pergjegjesite e njeri-tjetrit. Mungesa e dhenies se informacionit eshte arsyeja e mosmarreshjeve dhe tensioneve midis paleve.
- Disa nga palet e interesuara po e pengojne ecurine e reformes duke mos pranuar rolet dhe pergjegjesite e reja te caktuara nga pushteti vendor ose duke e pare veten si te lene jashte procesit.
- Asnje nga bashkite nuk e perdor fuqine e dhene nga ligji, keshtu si rezultat kerkohet nje iniciative me e larte nga ana e tyre.
- Autoritetet vendore ballafaqohen me 3 ceshtje kryesore: (a) mungesa e ekspertizes se nevojshme mbi ceshtjet e administrimit dhe menaxhimit te nderrmarjeve, (b) nderhyrjet e politikes ne reforme, dhe (c) humbja e memorjes institucionale.

## **Konkluzione dhe Rekomandime**

Ky studim nxjerr ne pah disa ngjashmeri dhe ndryshime midis qyteteve MP dhe atyre MSH.

Disa ngjashmeri qe jane vene re ne te dy grupet e qyteteve perfshijne (a) akses me te larte te furnizimit me uje se ne kanalizime, (b) tarifa e njehsuar eshte forma me dominuese e faturimit, (c) ne te gjitha qytetet e vezhguara pushteti vendor tani funksionin ne nje mjedis te ri institucional qe kerkon pershtatje dhe bashkepunim, (d) pushteti vendor po ndeshet me probleme qe kane te bejne me mungesen e ekspertizes dhe te humbjes se memorjes institucionale, (e) shkembimi i informacionit ndermjet paleve te interesuara eshte problematik, dhe (f) konsumatoret ne te dy tipet e qyteteve nuk kane mundesine e fjales ne procesin e vendim-marrjes.

Disa nga ndryshimet kryesore qe dallojne modelin e menaxhimit te nderrmarjeve nga Operatoret Private (OP) nga modeli i menaxhimit nga shteti perfshijne (a) lidhje me te pakta ne sherbimet e furnizimit me uje dhe kanalizime persa i perket siperfaqes se mbulimit dhe nje numer me i larte i lidhjeve te paligjshme dhe rezervuareve septike; (b) tarifa me te larta dhe nje shkalle me e ulet e permbushjes se nevojave per shkak te rritjes urbane te shpejte; (c) cilesi me e larte e aksesit, kohezgjatje e furnizimit dhe presion uji, ose cilesi e sherbimit qe vjen si rezultat i pjesemarrjes ne PREFU; (d) nje strategji e qarte per mbulimin e shpenzimeve te punes dhe mirembajtjes (P&M); (e) nje tarife ndihme prej 20 litrash ne dite per person pa pagese nga e cila do te perfitojne shtresat e varfera; (f) instalim i aparateve mates per te matur dhe kontrolluar konsumin; (g) nje program strategjik i zhvillimit te burimeve njerezore dhe perpjekje per ngritjen e kapaciteteve; (h) krijim papunesie per disa nga punonjesit e NU si pasoje e ristrukturimit te NU te menaxhuara privatisht; dhe (i) nje strukture institucionale disi e ndryshme, si pasoje e dy aksionereve shtese, KE dhe NJMK, te cilet jane pergjegjes per vendosjen e prioriteteve dhe marrjen e vendimeve te rendesishme ne qytete MP, perkundrejt Keshillit Mbikqyres (KM), i cili aprovon vendimet e rendesishme ne qytetet MSH. Ne kater qytetet e

menaxhuara privatisht vihet re nje perceptim i gabuar nga ndermarrjet vendore te ujit ne lidhje me KE dhe NJMK. Kjo vjen ndoshta per shkak te mungeses se transferimit te njohurive dhe shperndarjes se informacionit.

Duke kuptuar kompleksitetin e ristrukturimit te sektorit te ujit dhe kanalizimeve ne Shqiperi dhe duke u mbeshtetur ne analizen dhe gjetjet ne lidhje me ndikimet shperndarese dhe institucionale te reformes, ky studim paraqet nje numer rekomandimesh qe do te ndihmojne reformen, palet e interesuara dhe perfituesit, dhe vecanerisht shtresat e varfera ne zonat urbane.

Matrica e meposhte e politikave jep nje pershkrim te detajuar te rekomandimeve dhe sugjerimeve.

**Tabela 1. Matrica AVNS per Decentralizimin dhe Privatizimin e Reformes ne Sektorin e Ujit ne Shqiperi**

	Ceshtjet kryesore	Eshte e pranishme ne	Politikat e propozuara qe rekomandohen
<b>A. Kanalet e transmetimit</b>			
<b>1. Rritja e tarifave</b>	Mungesa e te dhenave te besueshme mbi mundesine qe kane konsumatoret per te paguar	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Duhet te behen anketime me grupe njerezish per te shikuar mundesine dhe deshiren e konsumatoreve per te paguar. Ndhima e autoriteteve vendore, vecanerisht ajo e njesise se ndihmes sociale dhe zyres se punes eshte e nevojshme. Angazhimi i shoqerise civile gjithashtu eshte i domosdoshem.
	Mendimi i konsumatoreve se tarifat jane aktualisht te larta dhe nuk ka permiresime te dukshme	Kryesisht prek qytetet MP	Rekomandohet qe perpara se te rriten me tej tarifat, konsumatoret te ndjejne te pakten nje lloj permiresimi ne furnizimin dhe lidhjen me uje. Njekohesisht, te behen fushata ndergjegjesimi te hapura dhe transparente per te perballuar cdo lloj kundershimi dhe moszbatimi. Per me teper, nje pune e madhe duhet te behet per te perfunduar instalimin e matesave perpara rritjes se tarifave; shumica e konsumatoreve thone se ata do te paguajne me shume vetem nese instalohen matesat ne menyre qe ata te mund te kontrollojne konsumin e ujit. Kjo prek me shume familjet e varfera.
	Konsumatoret nuk mund ta thone mendimin e tyre per vendosjen e tarifave	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Zbatimi i hapave te parashikuar ne SKUK per krijimin e paneleve te konsumatoreve, te cilet mendohet te perfaqesojne mendimin e klienteve.
	Mungesa e mekanizmave efikase per te detyruar [ata qe nuk paguajne]	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH (pervec Korces)	Te permiresohet detyrimi nepermjet angazhimit te policise se ujit dhe te jepet ndihme nga policia bashkiake nese eshte e nevojshme. Fushata e ndergjegjesimit te konsumatoreve duhet te ece paralel me kete per te shmangur cdo lloj kundershimi te mundshem.
	Vonesa ne zbatimin e ligjit per tarifat e ujrave te zeza per te gjitha ndermarrjet e ujit dhe te kanalizimeve	Qytetet e menaxhuara nga shteti, Vlora	Eshte e domosdoshme te zbatohet vendimi, ne menyre qe cdo konsumator qe perfiton nga sherbimi te puaguaje per ate [sherbimin]. Rekomandohet qe ky hap te shoqerohet me fushata sensibilizimi te cilat te kene si qellim rritjen e ndergjegjesimit te konsumatoreve.

	<b>Ceshtjet kryesore</b>	<b>Eshte e pranishme ne</b>	<b>Politikat e propozuara qe rekomandohen</b>
<b>2. Sherbimet e furnizimit me uje dhe sherbimet e kanalizimeve</b>	Mbulim jo i plote nga rrjeti, kryesisht per shkak te migracionit te brendshem te pakontrolluar, qe con ne lidhje te paligjshme, hapjen e puseve dhe rezervuare septike	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH, kryesisht me e ndjeshme ne qytetet me menaxhim privat	Investimet kapitale, nepermjet pjesemarrjes se donatoreve, jane te domosdoshme per te rritur nivelin e lidhjeve dhe per te permiresuar cilesine e lidhjeve, ne kuadrin e strategjise se uljes se varferise.
	Shkeputja e lidhjeve te jashteligjshme	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Lidhja e kontrates me kliente te jashteligjshem mendohet te jete nje alternative me e mire se shkeputja e lidhjeve, e cila nuk ka qene nje metode e suksesshme.
	Cilesi e jo e pershtatshme e ujit per shkak te kushteve sanitare te papershtatshme te burimeve te ujit dhe rezervuareve te ujit	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Burimet e ujit dhe rezervuaret e ujit duhet te konsiderohen objekte te nje rendesie te vecante persa i perket mbrojtjes se pershtatshme nga agjentet e jashtem. Per me teper, eshte e nevojshme te permiresohet procesi i klorinimit, duke e bere ate te krahasueshem me standartet nderkombetare.
	Cilesi jo e pershtatshme e ujit per shkak te infiltrimit te ujrave te zeza ne tubacionet e ujit	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH (kryesisht Durres, Fier dhe Gjirkaster)	Emergjenca per te rikuperuar rrjetet e furnizimit me uje dhe ata te kanalizimeve ne menyre qe te shmanget bashkimi i ujit te pijshem me ujrane te zeza. Vemendje e vecante duhet kushtuar gjate periudhes se veres, kur temperaturat i shtojne problemet e higjenes.
	Mungese e vendeve te trajtimit te ujrave te zeza	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Te shtohen perpjekjet per te ndertuar vende te trajtimit te [ujrave te zeza] ne Shqiperi duke ju dhene prioritet qyteteve ne zonat bregdetare, dhe vendeve te perpunimit qe po ndertohen ne Durres, Lezhe, dhe Sarande. Investimi kapital i vazhdueshem dhe bashkepunimi me donatore eshte i shume i redesishem.
	Nje sjellje e papershtatshme e konsumatoreve ndaj konsumit te ujit, e cila aktualisht veshtireson cilesine e lidhjes	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH (kryesisht qytetet MP)	Nje fushate e menduar mire e rritjes se ndergjegjesimit duhet te zbatohet ne secilen prej bashkive. Kjo eshte nje ceshtje komplekse e cila perfshin qe nga keqperdorimin e ujit dhe abuzimin me ujin deri tek, mospagimin, pagesat e vonuara, lidhjet e jashteligjshme, demtimin e matesave te ujit dhe keshtu me rradhe. Gjohet mund te perdoren si nje forme ndershkimi per dhunime te perseritura. Per shkak te kompleksitetit, kerkohet nje bashkepunim aktiv nga qeveria, bizneset dhe shoqeria civile gje e cila mund te sjelle sukses.

	<b>Ceshtjet kryesore</b>	<b>Eshte e pranishme ne</b>	<b>Politikat e propozuara qe rekomandohen</b>
<b>3. Mbeshtetje per shtresat e varfera nderpjjet ndihmes</b>	Papershtatshmeri e perceptuar dhe manipulime te kriterëve per familjet qe kualifikohen per ndihme	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Duhet te formulohen metoda alternative per te identifikuar familjet e varfera qe duhet te perfitojne. Mund te jete e nevojshme per pushtetin vendor qe te bashkepujone me aktoret e shoqerise civile. Mbikqyrja sistematike e atyre qe perfitojne eshte e nevojshme per te shmangur cdo lloj abuzimi te sistemit. Masa ndershkimore duhet te merren ndaj nepunesve te korruptuar.
	Papershtatshmeri e perceptuar per tarifen e ndihmes nga disa specialiste dhe familje	Qytetet MP	Zbatimi i tarifës së ndihmës kërkon instalimin e matesave. Deri sa të instalohen matesat, rekomandohet të përdoren forma të tjera të subvencioneve, të tilla si rritja e shumës së ndihmës ekonomike nga shtetit që përfitohet nga familjet e varfera. Në rastet e tilla rekomandohet që paratë t'u japin direkt ndermarrjeve të ujit. Kjo praktikë do të lejojë me shumë bashkëpunim ndermjet ndermarrjeve të ujit dhe pushteteve vendore perkatëse.
<b>4. Kanale te tjera te ndikimit</b>	Mungesa e ndergjegjesimit te njerezve per rendesine e ujit dhe kanalizimeve ne punesim	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Organizimi i fushatave të rritjes së ndergjegjesimit duhet të ketë si qëllim të shpjegojë rendesinë e menaxhimit të mirë të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe atyre të kanalizimeve. Këto fushata duhet të përqendrohen vecanerisht në lidhjen direkte ndermjet ujit, kanalizimeve dhe punesimit si dhe zhvillimit vendot ekonomik të secilës bashki.
	Prezenca e semundjeve qe kane te bejne me ujin apo qe lindin nga uji , kryesisht diarre, qe vine si pasoje e sistemit tejet te rrenuar te ujit dhe kanalizimeve	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH (kryesisht Durres, Fier, Gjirokaster dhe Lushnje)	Duhet përmirësuar urgjentisht infrastruktura e rrjeteve të ujit dhe të kanalizimeve si dhe të shmangët ndotja e ujit të pijshëm. Duhet përmirësuar metoda e klorinimit dhe përdorimi i dozës së saktë.
	Mungesa e ndergjegjesimit ndermjet specialisteve dhe njerezve mbi marredheniet ndermjet nje sistemi uji te permiresuar dhe vleres se tokes	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Ceshtjet që do të qartësojnë marrëdhëniet ndermjet infrastruktures së ujit dhe kanalizimeve dhe vlerës së tokës duhet të behen pjesë e fushatës së ngritjes së ndergjegjesimit; kjo mund të jete pjesë e strategjisë së fushatës së rritjes së shkallës së ndergjegjesimit.
<b>B. Ceshtje institucionale</b>			

	<b>Ceshtjet kryesore</b>	<b>Eshte e pranishme ne</b>	<b>Politikat e propozuara qe rekomandohen</b>
	Transferimi ngadalte i asetëve dhe aksioneve tek ndermarrjet e ujit ne pronesi te njesive te pushteteve vendore	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Perdorimi i formave dhe menyrave krijuese per transferimin e pronesise se asetëve ose aksioneve tek ndermarrjet e ujit ne njesite e pushteteve vendore, sic edhe eshte rekomanduar ne dokumentin e politikave qe eshte miratuar nga Keshilli i Ministrave
	Perceptim i gabuar per metoden e transferimit te asetëve vecanerisht ne rastet e sistemeve rajonale	Qytetet MP (Durres)	Transferimi i aksioneve perkundrejt transferimit te asetëve, mund te jete nje alternative me e mire.
	Nje perceptim i gabuar per KE dhe NJMK nga ndermarrjet vendore te ujit	Qytetet MP	Rritja e shkembimit te informacionit ndermjet aktoreve per te rritur nivelin e transparences konsiderohet si nje domosdoshmeri.
	Perceptim i gabuar per KM	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Rritja e shkembimit te informacionit ndermjet aktoreve per te rritur nivelin e transparences konsiderohet si nje domosdoshmeri.
	Mungese e kapaciteteve te pershtatshme ne nivel pushteti vendor, gje e cila vjen kryesisht nga informacioni i paplote dhe qe con ne mungese te iniciatives dhe motivimit	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Nevoja per te ofruan ndihme teknike dhe financiare si dhe trajnim per pushtetet vendore. Ujgenca per te shperndare dhe per te shkembyer informacion.
	Deshtim ne perfundimin e bashkimit te ndermarrjeve te ujit me ato te kanalizimeve	Qytete me menaxhim shteteror (Vlora)	Nevoja per te pershpejtuar ritmin e shkrirjes dhe lehtesimin e reformes ne progres nepermjet zbatimit te mekanizmave detyrues.

	<b>Ceshtjet kryesore</b>	<b>Eshte e pranishme ne</b>	<b>Politikat e propozuara qe rekomandohen</b>
	Mungese e hartave te rifreskuara te tubacioneve te ujit dhe te kanalizimeve per te drejtuar procesin e rikuperimit	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH (pervec Korces)	Dhenia e ndihmes teknike NU per te rifreskuar hartat aktuale, ne bashkepunim me specialistet e pushtetit vendor.
	Motivim dhe perkushtim i ulet nga ndermarrjet e ujit gje qe con ne korrupsion	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Vendosja e nje sistemi nxitesash, te tilla si rritje t pagave, rritje e perfitimeve te tjera dytesore, per te garantuar perkushtimin ne pune dhe per te permiresuar sherbimin.
	Ngurim per te ristrukturuar ndermarrjet e ujit. Masat lehtesuese te parashikuara ne SKUK shikohen si nje kompensim i pamjaftueshem	Qytetet MP	Te identifikohet nje strategji per te promovuar tregun e punes dhe per te krijuar vende pune te reja per ata qe do te preken negativisht. Bashkepunim maksimal ndermjet ndermarrjeve te ujit dhe pushteteve vendore dhe bizneseve vendore.
	Mendim se ecuria e reformes ndikohet nga klima politike ne vend	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Forcim i institucioneve apo futje e mekanizmave qe do te mundesojne ruajtjen e memorjes institucionale dhe do te mundesojne transferimin e informacioneve dhe njohurive.
	Mungese e treguesve mates per ecurine	Qytete me menaxhim shteteror (OP ne qytetet MP do ta dekretojne kete menyre)	Duhet te formulohen tregues te ecurise te bazuar ne axhenden e reformes institucionale, duke perfshire objektiva te qarta, rezultate dhe metoda te verifikimit.
	Deshtim ne krijimin e nje marredhenie besueshmerie me klientet	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Te vendoset nje mirekuptim shumeपालेश, kryesisht nepermjet, rritjes se transparences dhe permiresimit te sherbimeve. Secila per ndermarrjeve te ujit duhet te formuloje nje strategji komunikimi dhe te hape njesi te marredheneve me publikun per te zbatuar strategjine.

	<b>Ceshtjet kryesore</b>	<b>Eshte e pranishme ne</b>	<b>Politikat e propozuara qe rekomandohen</b>
<b>C. Baza ligjore per reformen</b>	Kuader ligjor i paplote qe nevojitet per te mbeshtetur zbatimin e reformes	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Urgjentisht duhet te ecet perpara me rregulloret dhe vendimet qeveritare qe ende nuk jane miratuar ende.
	Mungesa e nje mekanizmi efikas per detyrimin qe mundson zbatimin e ligjit	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Duhet te forcohen strukturat aktuale te detyrimit dhe te vendosen struktura te reja ne nivel vendor, vecanerisht kur behet fjale per pagesat e faturave.
<b>D. Pjesmarrja e sektorit privat</b>	Veshtiresi aktuale per privatizimin e plote	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Duhet bere privatizimi i pjesshem, i cili mund te filloje me shitjen e njesive te shitjes, gje qe mund te jete me sukses per realizueshmerine financiare te ndermarrjeve vendore.
	Veshtiresi per nje operator privat te hyje ne nje sektor me subvencione	Si qytetet MP ashtu dhe qytetet MSH	Ndermarrjet e ujit duhet te levizin gradualisht ne “zero” subvencione dhe te behen me terheqese per operatoret private. Mendohet gjeresisht se nje operator privat do te punoje me mire se nje operator shteteror.

### *Struktura e raportit*

Raporti është ndare në 6 kapituj dhe 13 shtojca. Kapitulli i parë përshkruan objektivat e studimit dhe gjetjet kryesore. Kapitulli i dytë shpjegon metodologjinë e studimit. Kapitulli vijues ofron (a) kontekstin e ecësive të reformës në sektorin e ujit, (b) një përshkrim të shkurtër të paleve të interesuara, si dhe (c) një përshkrim të shkurtër të varferisë, duke marrë parasysh faktin që ajo ndikon mbi shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Kapitulli i katërt jep një përshkrim të shkurtër të tërë qyteteve të përzgjedhura, kushtet aktuale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në tërë qytetet. Kapitulli pasardhës paraqet një përshkrim të detajuar dhe analize të shpërndarjes së ndikimit të reformës nëpërmjet pesë kanaleve të transmetimit dhe ve në dukje çështjet kryesore institucionale dhe problemet që paraqesin rrezikshmeri për reformën. Kapitulli i fundit jep rekomandime për politikën si dhe paraqet konkluzione.

## METODOLOGJIA

*Analiza mbi Varferine dhe Ndikimin Social* - Ky studim eshte nje analize mbi varferine dhe ndikimin social (AVNS) te reformes ne sektorin e ujit ne Shqiperi. Metodologjia e pare e AVNS ne Shqiperi eshte zhvilluar dhe pilotuar gjate muajve Maj-Korrik 2003, dhe ka marre ne studim kater qytete te nje madhesie mesatare: dy qytete me ndermarrje te menaxhuara privatisht nen Projektin e Ujrave dhe Kanalizimeve ne Bashki (PUKB) dhe dy qytete me ndermarrje te menaxhuara nga shteti. Studimi pilot paraqiti gjetje te rendesishme mbi perceptimin dhe sjelljen e konsumatoreve dhe institucioneve, persa i perket procesit te decentralizimit dhe te reformes ne sektorin e ujrave. Studimi yne e ngre nje shkalle me larte studimin pilot, ne nje total prej tete qytetesh: kater qytete te menaxhuara nga nje operator privat nen PUKB dhe kater qytete me ndermarrje te menaxhuara nga shteti. Kjo analize eshte zhvilluar gjate fazes se pare te punes se operatorit privat ne menaxhimin e kater ndermarrjeve te ujit nen PUKB.

*Perzgjedhja e vend-studimeve* - Qytetet u perzgjedhen nga Banka Boterore, sic edhe eshte percaktuar ne Termat e References (TR). Qytetet u perzgjedhen qe te perfaqesojne dy modele te menaxhimit te ndermarrjeve: ndermarrje te menaxhuara privatisht (Durrës, Fier, Lezhe, Sarandë) dhe ndermarrje te menaxhuara nga shteti (Lushnje, Gjirokaster, Korce dhe Vlore). Kjo perzgjedhje mundeson krahasimin ndermjet dy modeleve dhe ve ne prove supozimet e nenkuptuara per secilin model.

*Teknikat e kerkimit* – Ne kete studim jane perdorur te dyja llojet e teknikave, sasiore dhe cilesore per te mbledhur infomacion ne lidhje me ndikimet shperndarese te reformes. Teknikat e perdorura te kerkimit perfshijne si me poshte:

- *Rishikime nga tryeza* - Grupi kerkimor rishikoi literaturen ekzistuese mbi reformen e sektorit te ujit ne Shqiperi. Dokumentet e studiuara jane cituar ne fund te faqeve perkatese dhe ne seksionin e referencave.
- *Intervista me informatore kryesore ne nivel qeverie qendrore* - Jane bere tete intervista me informatore kryesore te qeverise qendrore. U zhvilluan gjithashtu intervista te tjera ne kete nivel per te trajtuar sic duhet ceshtjet shqetesuese qe u ngriten ne disa takime me eksperte. (Nje liste e detajuar e eksperteve te intervistuar dhe institucioneve perkatese eshte paraqitur ne Shtojcen 9.)
- *Intervista me informatore kryesore ne nivel pushteti vendor* – U zhvilluan te pakten 10 intervista me eksperte ne nivel vendor per secilin nga tete qytetet e projektit. U zhvilluan gjithashtu dhe intervista shtese ne disa nga qytetet, ne varesi te

karakteristikave te vecanta te qyteteve. (Nje liste e detajuar e eksperteve te intervistuar dhe institucioneve perkatese eshte paraqitur ne Shtojcen 9.)

- *Diskutime ne grupe fokusi* - Ne secilin qytet jane zhvilluar kater sesione diskutimesh ne grupe fokusi. Kujdes u tregua per te siguruar nje perfaqesim te balancuar te pjesemarresve dhe konsumatoreve, te cilet u perzgjedhen bazuar ne kriteret e meposhtme: karakteristikat demografike dhe socialo-ekonomike (gjinia, e kaluara socialo-ekonomike, e kaluara, niveli i arsimit e keshtu me rradhe) dhe cilesia e sherbimeve te produkteve dhe te sherbimeve te ujrave dhe te kanalizimeve (zona me presion uji te ndryshem, zona qe jane ose nuk jane te mbuluara nga rrjeti, familje me apo pa matesa dhe keshtu me rradhe).
- *Pyetesore socialo-ekonomik per familjet* – Grupi kerkimor i trajnuar organizoi nje ankete qe ka intervistuar 664 familje dhe qe mbuloi te tete bashkite. Anketa u krye duke intervistuar nje numer perfaqesuesish te nje minimumi prej 80 familjesh ne Fier, Gjirokaster, Lezhe, Lushnje, Korce, Vlore dhe Sarande si edhe nje grup perfaqesuesish prej 100 familjesh ne rajonin e Durresit (shih Shtojcen 13), duke perfshire fshatrat qe bejne pjese ne projekt. (Njezet pyetesore shtese u organizuan ne qytetin e Durresit ne menyre qe studimi te ishte ne raport te drejte me numrin e banoreve te cileve u ofrohet sherbim) Teknika e perzgjedhjes se personave ishte e shtresezuar dhe sporadike per secilin qytet. Kjo metode pati si qellim te perfshinte familjet tipike ne perputhje me kriteret e ndryshme, te tilla si mbulimi apo mungesa e mbulimit nga rrjeti, zona me presion te ndryshem uji, prezenca apo mungesa e matesve, e te tjera. Brenda secilit grup, perzgjedhja ishte sporadike per te siguruar nje perfaqesim te balancuar te familjeve te vendosura brenda dhe jashte zones se sherbimeve dhe anasjelltas.

## • KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT E REFORMES NE SEKTORIN E UJIT

### Historiku i Reformes ne Sektorin e Ujit ne Shqiperi

Infrastruktura e ujit dhe kanalizimeve ne Shqiperi eshte te pakten 30 vjecare. Si pasoje, ajo eshte perkeqesuar ne menyre te ndjeshme dhe rrjedhjet e shumta jane arsyeja e humbjes se konsiderueshme te ujrave<sup>1</sup>. Cilesia dhe sasia e ujit te furnizuar eshte shume poshte nivelit te deshiruar, nderkohe qe kanalizimet paraqesin nje problem edhe me akut, te shkaktuar nga mungesa e investimeve per permiresimin e rrjetit te kanalizimeve.

Migracioni i pakontrolluar drejt qyteteve kryesore te vendit ka rezultuar ne zgjerimin e kufijve te zonave urbane, por nuk eshte shoqeruar nga mbulimi me sherbime uji dhe te kanalizimeve ne shumicen e ketyre vendbanimeve te reja. Si pasoje e rritjes se numrit te lidhjeve te paligjshme ne rrjetin e ujrave dhe kanalizimeve, situata paraqitet serioze.

Qeveria Shqiptare (QSH) po perpiqet t'i jape nje zgjidhje ceshtjes se furnizimit te shtresave te varfera, nepermejt reformes se lehtesimit te varferise, e cila duhet te (a) siguroje sherbimet baze te furnizimit me uje dhe atyre te kanalizimeve per shtresat e varfera, (b) te siguroje uje te paster per popullaten te ciles i sherbehen, (c) te siguroje furnizim me uje qe mund te paguhet, dhe (d) te rrise nivelin e sherbimeve te ujit dhe te kanalizimeve ne zonat e lena pas dore. Ne te njejten kohe, reforma ka si synim te nxise: realizueshmerine financiare te ndermarrjeve te ujit nepermjet rritjes se tarifave, nje nivel te permiresuar te mbledhjes se pagesave me detyrim, shkeputjen e lidhjeve te paligjshme, dhe keshtu me rradhe.

Per te trajtuar kete ceshtje emergjente ne kete sektor jetesor te ekonomise, QSH e ka deklaruar reformen ne sektorin e ujrave dhe kanalizimeve si nje pjese te rendesishme te Strategjise Kombetare per Zhvillim Ekonomik dhe Social (SKZHES). Kjo reforme ka si synim te permiresoje efikasitetin dhe efektivitetin e ketyre sherbimeve, te siguroje lidhje me sherbimet infrastrukturore baze, dhe te permiresoje kujdesin per familjet me te ardhura te ulta.

Dy dokumentat kryesore qe drejtojne reformen jane (a) Ligji Nr. 8652 mbi "Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverise Vendore (OFQL)" (Qeshor 2000) dhe (b) Shqiperia: Strategjia e sektorit te furnizimit me uje dhe kanalizimeve (Qershor 2003). Ndermarrja e tre hapave kryesore eshte shume e rendesishme per kete proces dhe suksesin e reformes:

---

<sup>1</sup> Sistemi eshte krijuar per t'u sherbyer nevojave te nje kohe ku perdorej shume me pak uje. Nderkohe qe mirembajtja e pershtatshme ka munguar, nderhyrjet e paautorizuara ne infrastrukturen e sistemit kane bere qe sistemi te rrenohet shume shpejt

*Inventari i asetëve dhe transferimi i kompetencave tek qeveria vendore.* Inventari i asetëve që është organizuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (MRRTT) është perfunduar për të 53 ndermarrjet e ujrave në vend, përveç Korçes ku inventari duhet të llogaritet duke marrë parasysh investimet e KfW. Masa tjetër që duhet ndermarrë është klasifikimi i NU në përputhje me zonën e tyre të shërbimit, duke filluar nga ato ndermarrje që janë me komplekse (ndermarrje rajonale). Inventari i asetëve ka provuar të jetë i vështirë për sistemet rajonale të ujit, duke ndikuar kështu në ecurinë e reformës.

*Vlerësimi i situatës financiare dhe lloji aktual i menaxhimit të secilës prej NU* -. Sipas një eksperti në Ministrinë e Financave (MF), shumica e NU kanë trashëguar borxhe që pengojnë ecurinë e reformës së decentralizimit. Eksperti tha se një nga sfidat më të cilat përballen NU është pagesa e borxheve ndaj Korporatës Kombëtare të Energjitikës të Shqipërisë (KESH) gjatë 2005, afat ky brenda të cilit subvencionimi i shtetit ndaj NU për të paguar borxhin ndaj KESH pritet të mbarojë. I njëjti ekspert mendon se transferimi i plote do të varet nga pagesat e prapambetura të ndermarrjeve, si dhe kapaciteti i pushtetit vendor për të dhënë fonde investimesh nga burime të tjera përveç granteve pakushte të kufizuara të qeverisë qendrore, të cilat nuk mund të financojnë investime në shkallë të gjere.

*Perfundimi i kuadrit ligjor si një domosdoshmëri për mbështetjen e reformës është hapi i tretë dhe perfundimtar.* Sipas njerit prej ekspertëve të qeverisë qendrore, baza ligjore jo e plote që mbështet reformën, pengon ecjen përpara të saj. Sipas drejtorit të Departamentit të Decentralizimit në MPVD është i domosdoshëm rishikimi i ligjit aktual dhe i akteve mbi decentralizimin dhe reformën në sektorin e ujit.

### *Ecuria e Reformës*

Gjatë vitit 2003, reforma e decentralizimit kaloi nëpërmjet një procesi të “autonomisë funksionale dhe fiskale” por objektivi kryesor i saj që kishte të bënte me delegimin e kompetencave të qeveria vendore nuk u përmbush. Ligji mbi “Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore” përcakton se decentralizimi i funksioneve të sektorit të ujit dhe transferimi i kompetencave tek pushteti vendor do të hyjnë në fuqi më datën 1 Janar 2002. Megjithatë inventari është perfunduar për të gjitha ndermarrjet e ujit (me përjashtim të njërës prej tyre) dhe nga qeveria janë dhënë vazhdimisht subvencione për të paguar borxhet e ndermarrjeve, asnjëra nga të tete NU, të cilat janë edhe fokusi i këtij studimi, nuk është transferuar tek pushteti vendor. Disa eksperte të qeverisë qendrore parashikuan që kalimi i plote i pasurisë dhe i kompetencave do të arrihej brenda vitit 2004, nderkohe që eksperte të tjera e konsideruan perfundimin e decentralizimit të sektorit të ujit brenda vitit 2005 si një sfidë të vërtetë.

Per te lehtesuar ecurine e reformes, kohet e fundit jane nxjerre nje numer urdheresash<sup>2</sup>, por megjithe angazhimin e qeverise qendrore per t'i cuar perpara perpjekjet per decentralizim, ecuria e reformes ka qene teper e ngadalte. Objektivat qe kane te bejne me decentralizimin e funksioneve te sektorit te ujit dhe transferimin e kompetencave ne qeverine vendore nuk jane permbushur. Zbatimi dhe sukcesi i reformes se ujit varet jo vetem nga mbeshtetja e qeverise qendrore por edhe nga mbeshtetja dhe iniciativa e pushtetit vendor.

## **Struktura Institucionale e Sektorit te Ujit dhe Palet e Interesuara ne Reforme**

Ne analizen e meposhtme palet e interesuara jane ndare ne tre grupe: (a) pale te interesuara qe ndikojne mbi reformen, (b) pale te interesuara qe preken nga reforma (pozitivisht apo negativisht), dhe (c) pale te interesuara qe ndikojne mbi politikat e reformes.

*Pale te interesuara qe ndikojne mbi reformen*

### **Qeveria Qendrore (QQ)**

*Keshilli i Ministrave (KM)* luan nje rol kyc ne hartimin e komponenteve ligjore te reformes. KM eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e ligjeve ne Parlament si dhe nxjerrjen e vendimeve. Nga ana e qeverise qendrore eshte vene re nje perkushtim politik per te punuar me formulimin e strategjise se decentralizimit; megjithate, mbeshtetja nga ana e saj gjate fazes se zbatimit nuk ka qene ne shkallen e duhur.

*Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit (MRRTT)*, luan nje rol te rendesishem ne procesin e reformes. MRRTT eshte pergjegjese per hartimin e strategjise dhe politikave ne sektorin e ujit, hartimin e politikave te investimeve nepermjet planifikimit dhe shperndarjes se fondeve te investimeve, politikave te subvencioneve nepermjet planifikimit dhe shperndarjes se subvencioneve, si dhe per berjen e inventarit te asetave pronave te ndermarrjeve te ujit per te transferuar NU tek pushteti vendor. MRRTT dhe MPVD jane angazhuar si ne zbatimin e reformes ashtu dhe ne procesin e transferimit. Megjithate nuk jane percaktuar afate per te plotesuar keto detyra. MRRTT perfaqeson qeverine ne Keshillin Mbikqyres te ndermarrjeve te ujit dhe ne Komitetin Ekzekutiv (KE).

---

<sup>2</sup> Per nje informacion me te detajuar shih Shtojcen 1

*Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD)* luan rolin kryesor ne zbatimin dhe bashkerendimin e reformes se decentralizimit ne te gjithë sektoret, duke perfshire decentralizimin ne sektorin e ujit. Ajo cfare eshte me e rendesishme eshte se MPVD ndjek transferimin e NU ne pushtetet vendore perkatese. Gjithashtu, [MPVD] perfaqeson qeverine qendrore ne Komitetin Ekzekutiv te kater ndermarrjeve te ujit me kontrata menaxhimi. Drejtoria e Decentralizimit brenda ministrise eshte aktori kryesor pergjegjes per nxitjen e reformave.

*Ministria e Ekonomise (ME)* si pronare e asetëve, eshte pergjegjese per hartimin e ligjeve dhe zbatimin e politikave te privatizimit per kete sektor strategjik. Disa nga pergjegjesite kryesore te saj ne procesin e reformes ne sektorin e ujit jane vleresimi i asetëve dhe dhenia e ndihmes per bashkimin e ndermarrjeve te ujit me ato te kanalizimeve si dhe transformimin e ketyre ndermarrjeve ne kompani aksionere.

*Ministria e Financave (MF)* eshte pergjegjese per dhenien e subvencioneve NU. Specialistet e intervistuar kane konfirmuar se shumica e NU kane borxhe te trasheguara, te cilat kane ngadalesuar ecurine e transferimit. Shlyerja e borxheve te ndermarrjeve ndaj KESH brenda vitit 2005 konsiderohet nje sfide per MF. Duke patur parasysh situaten financiare te NU ne Shqiperi, roli i MF eshte teper i rendesishem ne pershejtimin e ecurise se reformes.

### **Enti Rregullator i Ujit (ERRU)**

ERRU eshte nje entitet i pavarur qe u krijua sipas ligjit te vitit 1996 mbi “Kuadrin rregullator ne sektorin e furnizimit me uje, derdhjeve, dhe perpunimit te ujrave te zeza”. Ne kuader te reformes se decentralizimit, autoriteti per percaktimin e tarifave do te transferohet tek pushteti vendor; megjithate, per shkak te vonesave ne procesin e decentralizimit, ERRU vazhdon te gezoje kete autoritet. Roli dhe pergjegjesia e ardhshme e ERRU do te perqendrohen ne hartimin e modeleve per vendosjen e tarifave dhe lehtesimin e vendimeve te marra nga PV. ERRU ka te drejten ligjore te vezhgoje dhe te leshoje gjoba ne rastet e shkeljeve ligjore; megjithate kjo nuk eshte zbatuar ne praktike.

### **Pushteti vendor (PV)**

Pritet qe pushtetet vendore jo vetem te perfitojne nga reforma por te marrin edhe pjese aktive ne te. Megjithate, per shkak te nje vonese ne procesin e decentralizimit bashkrite nuk kane mundur te ushtrojne te gjitha te drejtat e tyre sic parashikohen ato ne ligj. PV po punon tashme ne nje ambjete te ri institucional i cili perfshin (a) nje status te ri per NU; (b) nje projekt-marreveshje te sherbimeve te nenshkruar nga bashkia dhe NU; (c) nje kod te ri te ujit; dhe (d) nje Komitet Ekzekutiv ku kater pushtetet vendore kane

perfaqesues. Pushtetet vendore ne kater qytetet me kontrate menaxhimi privat priten te luajne nje rol me aktiv nepermjet pjesemarrjes ne KE

Autoritetet vendore perballen me dy ceshtje kryesore:

- Ceshtja e pare eshte mungesa e ekspertizes se nevojshme per ceshtjet e administrates dhe menaxhimit te ndermarrjeve. Durresi eshte nje rast tipik, me veshtiresite dhe paqartesite qe vijne jo vetem si pasoje e kompleksitetit te sistemit por edhe nga mosaftesia e pushtetit vendor per te shqyrtuar ne menyre te pershtatshme ceshtjet shqetesuese
- Ceshtja e dyte ka te beje me prekshmerine [influencimin] e NU nga procesit politik, rast ne te cilin disa nga administratoret e rinj mund te perfaqesojne emerime politike dhe si te tille nuk jane specialiste teknike. Ky mund te jete nje shqetesim i vecante per Korcen, ku ndermarrja e ujit po punon ne menyre efikase.


### **Njesia e Monitorimit te Kontrates (NJMK)**

NJMK po con me tej eksperiencen e Projektit te Rehabilitimit Emergjent te Furnizimit me Uje dhe po e zgjeron perqendrimin e saj ne permiresimin e kapaciteteve menaxheriale, perkrah nderhyrjeve teknike dhe fizike. Kjo kontrate prezanton dy aktore te tjere ne strukturen institucionale te sektorit te ujit. Ne dallim nga KE i cili eshte nje organizem politik, NJMK merret vetem me ceshtjet teknike.

### **Komiteti Ekzekutiv (KE)**

KE u krijua mbi baze te vendimit te Keshillit te Ministrave per te menaxhuar Kredine e Bankes Boterore (BB). KE eshte organi kryesore ne vendim-marrje, dhe gezon autoritetin per te rishikuar dhe aprovuar veprimet e ndermarra nga operatoret private. Ky komitet perbehet nga shtate anetare, tre nga te cilet i perkasin ministrive te linjes (MRRTT, MPVD dhe ME), dhe kater anetare te tjere jane perfaqesues te pushtetit vendor nga kater qytetet e projektit. Te gjitha anetaret jane te emeruar nga Keshilli i Ministrave. Durresi ben perjashtim, pasi ka nje system rajonal te furnizimit me uje dhe per kete arsye perfaqesohet nga autoritetet rajonale, nderkohe qe tre qytetet e tjera [te projektit] perfaqesohen nga autoritetet e bashkise. Ne kete proces, KE ndihmohet nga NJMK, e cila merret me pjesen teknike te projektit

**Figura 1: Harta Institucionale e Struktures se Qeverisjes ne Sektorin e Ujit**



## **Keshilli Mbikqyres (KM)**

KM eshte nje strukture e formuar pas muajit Tetor te vitit 2003, kur NU u transformuan ne kompani aksionere. Kjo strukture zevendesoi bordin drejtues te meparshem te NU. Dy te tretat e KM perbehen nga perfaqesues te qeverise qendrore (MRRTT dhe ME) dhe vetem nje anetar eshte perfaqesues i pushtetit vendor. Ky i fundit eshte zakonisht nenkryetari i bashkise dhe eshte ne kontakt te drejtperdrejt me drejtorin apo punonjes te tjere te NU. KM mund te mblidhet sa here qe NU vendore e shikon te nevojshme. Nje vendim, qe pritet te miratohet KM, do te ndryshoje raportin midis perfaqesuesve te MP dhe PV ne favor te ketyre te fundit.

## **Agjensite e trajnimit**

Reforma ne sektorin e ujit parashikon trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve per personelin vendor per te shoqeruar keshtu transferimin e kompetencave tek pushteti vendor. Ne kuadrin e procesit te decentralizimit, GTZ ka marre persiper pergjegjesine e pergatitjes se programeve te trajnimit per kryetaret e bashkive dhe komunave. Per me teper Drejtoria e Pergjithshme e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve po pergatit nje manual dhe nje tregues teknik mbi administrimin e sistemit te furnizimit me uje. Ashtu sikurse dhe percaktohet ne Strategjine Kombetare te Ujit dhe Kanalizimeve (SKUK), Shoqata e Furnizuesve me Uje dhe Ndermarrjeve te Kanalizimeve ne Shqiperi, me mbeshtetjen e ministrive te linjes, eshte nje tjetere pale e interesuar qe do te perfshihet ne menyre aktive ne procesin e ngritjes se kapaciteteve.

### *Palet e interesuara te prekura pozitivisht nga reforma*

*Pushtetet vendore* se shpejti do te ushtrojne pergjegjesite e tyre te ofrimit te sherbimeve te furnizimit me uje dhe kanalizimeve si dhe do te perfitojne nga programet e trajnimit dhe ngritjes se kapaciteteve. Autoritetet vendore ne kater qytetet me kontrate menaxhimi privat do te kene role shtese te pershtatura me planin e aprovuar te veprimit te OP.

*Ndermarrjet e ujit* - Duke filluar me transformimin e NU ne kompani aksionere, reforma ka si qellim te rrise realizueshmerine financiare te ndermarrjeve. Ne kete drejtim, kater ndermarrjet me MP pritet te perfitojne nepermjet rritjes se te ardhurave te ndermarrjes dhe personelit i cili do te jete me i trajnuar.

*Konsumatoret* (shteterore, private, dhe familjare) pritet te perfitojne nga rritja e aksesit dhe furnizimi me uje te rrjedhshem me cilesi dhe me presion te larte per me shume ore ne dite dhe me shume dite ne jave. Mendohet se perfitimet do te jene me te medha per familjaret ne kater qytetet MP si rezultat i investimeve ne shkalle te gjere qe do te permiresojne infrastrukturen.

*Familjet tejet te varfere* - Per kater ndermarrjet e ujit te menaxhuara privatisht ne Durres, Sarande, Fier, dhe Lezhe, Keshilli i Ministrave ka perfshire nje forme te re subvencioni per familjet me te ardhura shume te pakta, te cilat nuk jane ne gjendje te

paguajne faturat e tyre te ujit. Subvencioni perbehet nga nje tarife ndihme prej 20 litra per person ne dite qe mendohet te hyje ne fuqi gjate vitit 2004.

#### *Palet e interesuara te prekura negativisht nga reforma*

*Familjet perdoruese te paautorizuara* - Nje nga klauzolat e SKUK trajton ceshtjen e prerjes se lidhjeve te paautorizuara ne tubacionet e ujit. Nese nje mase e tille zbatohet, kjo mund te ndikojte negativisht mbi standartin e jeteses se ketyre familjeve pasi do t'i shtyje ato te kerkojne menyra te tjera furnizimi, si blerja e ujit ne dyqane, dhe do te rrise shpenzimet e familjes. Mundesia qe qeveria te jete e suksesshme ne kete perpjekje eshte e vogel, duke patur parasysh qe perpjekjet e meparshme te bera nga NU kane deshtuar, dhe qeveria nuk ka nje menyre trajtimi te hollesishme per te trajtuar perdoruesit e paligjshem.

*Bizneset si perdorues te paautorizuar* - te tilla si lavazhet e makinave apo kompanite e ndertimit qe perdorin ujin e pijshem per bizneset e tyre - jane nje grup tjetër qe do te ndikohet negativisht nga reforma. Mendohet se nderprerja e furnizimit me uje (ne rastet e lavazheve te makinave) ose instalimi i matesave i shoqeruar me tarifat e rritura te ujit do te kete nje ndikim jo te mire mbi kete grup dhe mund te shkaktojte reagime negative.

#### *Palet e interesuara qe ndikojne mbi reformen*

*Qeveria dhe ndermarrjet e ujit* jane pale te interesuara te nje rendesie te vecante duke marre ne konsiderate rolin qe ato luajne mbi reformen. Eshte e rendesishme te theksohet qe segmente te tjera te shoqerise civile ndikojne mbi reformen te tilla si Shoqata Shqiptare e Ndermarrjeve te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve (SHSHNFUK), e cila eshte nje organizate shume premtuese, shume aktive dhe qe mbeshtet reformen e decentralizimit. Ne bashkepunim te ngushte me ministrite e linjes SHSHNFUK do te hartojte dhe zbatojte programet e trajnimit per pushtetet vendore dhe NU dhe do te beje konsulta me to. Per me teper SHSHNFUK mendon se kur autoriteti dhe pronesia mbi asetet te jene transferuar tek pushtetet vendore, keta te fundit do t'i japin nje mbeshtetje institucionale shoqates dhe bashkepunimi ndermjet tyre do te jete me i ngushte dhe me efikas.

## **Varferia ne Shqiperi ne Konteksin e Reformes ne Sektorin e Ujit**

Shqiperia mbetet nje nga vendet me te varfere te Europes, me nje GDP prej US\$ 1,100 per banor<sup>3</sup>. Varferia ka nje dimension monetar qe matet nga te ardhurat ose shpenzimet, por gjithashtu ka edhe nje dimension jomonetar. Ky i fundit eshte shume i gjere dhe perfshin pasjen e sherbimeve baze, te tilla si shkollimi, sherbimi shendetesor dhe sherbimet e shendetesise, uji, kanalizimet, punesimi, perfshirja shoqerore, pergjegjesia, pjesemarrja dhe fuqizimi i shoqerise civile. Cilesia e ulet e lidhjeve ne sherbimet baze eshte nje nga ceshtjet kryesore qe ka te beje me varferine e shtresave qe

---

<sup>3</sup> Studimi i Matjes se Standarteve te Jeteses (2002)

nuk kane te ardhura ne Shqiperi (De Soto dhe te tjere 2002). Studimi yne do te perqendrohet kryesisht ne dimensionin jomonetar te varferise dhe efektet e furnizimit me uje dhe sherbimet e kanalizimeve.

Sipar raportit “Varferia ne Shqiperi: Nje Vleresim Cilesor” (2002), per sa i perket ujit dhe kanalizimeve, aksesit eshte i ulet, dhe cilesia e sherbimeve te ofruara eshte gjithashtu e ulet edhe ne zonat urbane. Shume shqiptare i shikojne problemet e infrastruktures si shkakun e trete kryesor qe ndikon mbi veshtiresite qe ata ndeshin dhe standartin e ulet te jeteses, pas te ardhurave te ulta dhe papunesise se larte. Te dhenat nga i njejti raport tregojne se rreth 35 perqind e shqiptareve permendin mungesen e furnizimit me uje si problemin me emergjent. Rreth 71 perqind e te anketuarve jane shprehur se kane uje por uji vjen vetem mesatarisht 11 ore ne dite. Shqiptaret shpesh i lidhin problemet e tyre me cilesine e ulet te ujit dhe sherbimet e papershtatshme.

Te dhenat pershkruese te marra nga ky studim ne tete qytetet e perzgjedhura tregojne se nje mesatare prej 20.7 perqind e familjeve te intervistuar (24.5 perqind ne kater qytetet MP dhe 16.6 perqind ne kater qytetet MSH) e konsiderojne cilesine e sherbimeve si problemin me urgjent. Nje mesatare prej 90 perqind e familjeve (82.2 perqind ne qytetet MP dhe 99 perqind ne qytetet MSH) kane furnizim me uje, nderkohe qe numri mesatar i oreve te furnizimit me uje ndryshon shume nga nje qytetet ne tjetrin.

Mospërputhjet midis grupeve te te dhenave mund te vijne kryesisht per shkak te perfshirjes se zonave rurale ne studimin e vitit 2002, fakt qe ul ndjeshem shifrat e furnizimit me uje, nderkohe qe qellimi i studimit tone eshte furnizimi me uje dhe lidhja me kanalizimet ne zonat urbane. Per me teper, duhet te theksojme se shifrat e ulta te dukshme te familjeve qe nuk kane lidhje uji ne studimin tone mund te vijne si pasoje e perdorimit te mekanizmave te perballimit, sic jane rezervuaret e ujit, te cilet e rrisin numrin e oreve te furnizimit me uje, duke ndikuar keshtu mbi mendimin e konsumatoreve per cilesine e furnizimit me uje.

Cilesia e sherbimit te ujit dhe kanalizimeve duket se ka te beje me vendbanimin dhe varferine. (Shih detajet e diskutimit ne kapitullin Gjetje dhe Analiza) . Per kete arsye ky studim do te studioje gjeresisht marredheniet qe ekzistojne ndermjet varferise dhe furnizimit me uje dhe kanalizimeve ne vendbanimet e jashteligjshme, te tilla si Keneta e Durresit. Shkalla e shperndarjes se varferise<sup>4</sup> ishte e ngjashme ne te gjitha qytetet e studiuara.

---

<sup>4</sup> Klasifikimi eshte marre nga Hermine De Soto dhe te tjere. 2002. “Poverty in Albania: A Qualitative Assessment.” The World Bank. Washington D.C.

## PROFILET E QYTETEVE

Ky kapitull perpiqet te jape nje pershkrim te ngjashmerive dhe ndryshimeve ndermjet tete qyteteve persa i perket furnizimit, faturimit, mbulimit nga rrjeti, raportit midis mbledhjeve dhe humbjeve te ujit si dhe ndermjet dy modeleve te menaxhimit te sherbimeve te ujit. (Profile te detajuara te qyteteve jane dhene ne Shtojcen 4).

### *Aksesi*

Te tete qytetet jane shume te ndryshem per sa i perket numrit te popullsisë, nga 33,000 banore ne Lezhe ne 173,542 banore ne Durres. Sic edhe eshte treguar ne Tabelen 2, numri i banoreve eshte rritur ne menyre drastike gjate 13 vjeteve te fundit, duke kontribuar ne perkeqesimin e infrastruktures se ujit dhe te kanalizimeve. Te dhenat nga burimet bashkiake tregojne se rritja e popullsisë ka qene me e larte ne qytetet MP se sa ne qytetet e tjera<sup>5</sup>.

Migrimi i brendshem eshte identifikuar si nje tregues qe ka pasoja te rendesishme mbi cilesine e ujit dhe sherbimeve te kanalizimeve. Shkalla e ndertimit te vendbanimeve te reja, te cilat nuk jane te mbuluara sic duhet nga rrjeti i ujit dhe kanalizimeve, ishte me e larte ne kater qytetet MP. Ne qytetet MP familjet kane raportur se kane lidhje me te pakta ne sherbime per sa i perket kohezgjatjes dhe presionit te furnizimit me uje, tarifa me te larta, numer me te larte te lidhjeve te paligjshme, shkalle me te larte mosperputhjeje ndermjet numrit real te perdorimit, te perdoruesve dhe numrit te konsumatoreve me kontrate, nje numer me te larte te rezervuareve septike dhe keshtu me rradhe. Aksesi i papershtatshem ne sherbimet e ujit ka shkaktuar nje rritje te numrit te puseve te hapuara nga vete njerezit, vecanerisht ne qytetet Fier dhe Lushnje.

Shtate prej tete qyteteve te perzgjedhura ofrojne sherbime vetem per zonat urbane, pervec Durresit, i cili ka nje sistem rajonal dhe iu ofron sherbime tre bashkive dhe gjashte komunave. Si nje ofruer rajonal i sherbimeve te ujit dhe te kanalizimeve Durresi paraqet nje rast te pazakonte persa i perket ceshtjeve te lidhjeve ne rrjet, transferimit te asetëve dhe aspekteve te tjera te reformes.

### *Faturimi*

Faturimi shfaq karakteristika te ngjashme ne te kater qytetet me kontrate menaxhimi privat, ku faturimi i njehsuar eshte metoda kryesore, dhe ku konsumi i matur i pjesshem eshte rezultat i PREFU. Nga ana tjeter NU e Korces e bazon faturimin vetem ne konsumimin e matur. Vlora perdor kryesisht faturimin e njehsuar duke patur shume pak konsumatore me matesa; Lushnja dhe Gjirokastra varen plotesisht mbi faturimin e njehsuar. Studimi yne eshte perpjekur te shpjegoje marredheniet ndermjet tipit te sistemit te faturimit dhe sjelljes se konsumatoreve kundrejt konservimit te ujit, pageses se faturave te ujit, dhe situates financiare te NU. (Shih diskutimin me te detajuar ne

---

<sup>5</sup> Te dhenat mbi popullsinë perreth qytetit nuk ekzistojne.

kapitullin Gjetje dhe Analiza). Nje nga masat e vendosura nga reforma eshte vendosja universale e matesave. Kater qytetet me kontrate menaxhimi privat priten te kene rritje me te madhe te tarifave. (Nderlikimet e ketyre masave jane diskutuar ne kapitullin Gjetje dhe Analiza).

### *Niveli i mbledhjeve te pagesave*

Niveli i mbledhjeve te pagesave shikohet si nje kombinim i mundesise dhe deshires per te paguar. Ne te njejten kohe, raporti i mbledhjeve eshte nje tregues tjetër i efikasitetit dhe realizueshmerise financiare te ndermarrjeve te ujit. Si i tille, raporti i mbledhjeve mund te konsiderohet edhe si nje tregues i nevojës absolute per te percaktuar strategji te reja dhe/ose mekanizma per te permiresuar detyrimin.. Nje nivel i permiresuar i mbledhjeve do te forcoje te ardhurat e ndermarrjeve duke u bere te mundur atyre te mbulojne kostot e administrimit dhe menaxhimit, dhe keshtu te ule subvencionet e shtetit per sektorin. Kjo mund te sjelle nje pjesemarrje me aktive dhe efikase te qeverise qendrore me kapital investues.

### *Humbjet e ujit*

Humbjet e ujit jane prezente ne te gjitha qytetet pervec Korces. Humbjet e ujit shikohen si nje kombinim i kushteve te papershtatshme teknike te rrjetit dhe faktorit njerezor sic jane: sjellja e konsumatoreve kundrejt konsumit te ujit. Humbja e ujit shfaq nderlikime te qarta ne cilesine e sherbimeve, e cila ndikon mbi permbushjen e deshirave te konsumatoreve per sherbimin.

Tabela 2 perfaqeson nje permbledhje te te dhenave socialo-ekonomike dhe teknike qe kane te bejne me analizen tone. Tabela prezanton nje krahasim me te mire te tete qyteteve te studiuara, vecanerisht kur merret ne analize ndikimi i shperndarjes se reformes. Ne pergjithesi, situata e furnizimit me uje dhe sherbimeve te kanalizimeve ne te gjitha qytetet e studiuara, pervec Korces, eshte e njejte persa i perket humbjeve te ujit, faturimeve, dhe niveleve te mbledhjeve te pagesave. Qytetet jane grupuar ne qytete me kontrate menaxhimi privat dhe qytete te menaxhuara nga shteti, dhe te dhenat jane paraqitur per secilin grup ne menyre te vecante. Ne grupin e pare (qytetet MP) eshte prezent nje operator privat i cili eshte gati te investoje dhe ka edhe nxitjen per ta bere kete, por ky fakt sjell me vete problemin e rritjes se ndjeshme te tarifes. Ne grupin e dyte (qytetet MSH) eshte prezent nje operator publik, i cili ka kapacitet investimi te kufizuar, por praktikon nje qendrim te “orientuar drejt konsumatorit”. Ceshtja e tarifave konsiderohet te jete vecanerish e rendesishme per qytetet MP, ku tarifat aktuale jane me te larta se ato ne qytetet e tjera. Te dhenat e lidhjeve nga ana tjetër tregojne se ato jane pak me te ulta ne qytetet MP, ndoshta per shkak te rritjes se numrit te popullsisë, gje e cila do te thote se ka rritje te kerkeses per furnizim me uje.

Tabela 2. Kushtet dhe Aksesit ne Infrastrukturen e Ujit dhe Kanalizimeve ne tete qytetet e studiuara

**Tabela 2. Kushtet dhe Aksesit ne Infrastrukturen e Sistemit te Ujrave dhe Kanalizimeve ne Tete Qytetet e Studiuara**

	Qytetet me menaxhim privat				Qytetet me menaxhim shteteror			
	Durrës	Fier	Lezhe	Sarandë	Korçë	Gjirokaster	Vlorë	Lushnjë
Zona (ne km kuadrate)	433	720	437	149	1,530	1,137	1,609	712
Popullsia (te dhena nga anketimi i 2001)	113,465	76,166	16,592	14,553	58,911	22,866	85,180	38,336
Popullsia (te dhena nga bashkite)	173,542	109,925	33,000	32,000	84,000	34,250	115,396	61,000
Rritja e popullsisë ne (%) (1989–2003)	210	255	340	203	132	142	160	204
Niveli i papunesisë, 2001 (%)	27.05	20.07	12.88	19.58	21.76	23.12	27.23	27.05
Familjet qe perfitojne ndihme ekonomike	1010 (2.27%)	1330 (5.2%)	792 (13%)	153 (1.9%)	1944 (8.3%)	320 (3.5%)	2007 (7%)	1500 (10%)
Aktivitetet kryesore ekonomike (qe kane te bejne me ujin)	Turizem dhe sherbime	Sherbime te perpunimit te ushqimeve	Peshkim, turizem dhe sherbime	Peshkim, turizem dhe sherbime	Birrari dhe sherbime te perpunimit te ushqimeve	Sherbime te perpunimit te ushqimeve	Turizem, peshkim dhe bujqesi	Perpunim ushqimesh dhe bujqesi
Aktivitetet ekonomike kryesore (qe nuk kane te bejne me ujin)	Tregeti, ndertim, ndermarrje veshmbathjesh, transport dhe bujqesi	Ndertim, ndermarrje veshmbathjesh, transport dhe bujqesi	Ndertim	Ndertim	Ndermarrje veshmbathjesh, tregeti dhe ndertim	Ndertim dhe ndermarrje veshmbathjesh	Ndertim, ndermarrje veshmbathjesh dhe tregeti	Ndermarrje veshmbathjesh, ndertim dhe industri
Zona e mbuluar nga rrjeti i ndermarrjes se ujit	Rajonal	Bashkiak	Bashkiak	Bashkiak	Bashkiak	Bashkiak	Bashkiak	Bashkiak
Sistemi i faturimit	Kryesisht tarife e njehsuar e kombinuar me konsum te matur	Kryesisht tarife e njehsuar e kombinuar me konsum te matur	Kryesisht tarife e njehsuar e kombinuar me konsum te matur	Kryesisht tarife e njehsuar e kombinuar me konsum te matur	Konsum i matur	Tarife e njehsuar	Kryesisht tarife e njehsuar e kombinuar me konsum te matur	Konsum i matur

	Qytetet me menaxhim privat				Qytetet me menaxhim shtetëror			
	Durrës	Fier	Lezhe	Sarandë	Korçë	Gjirokastër	Vlorë	Lushnjë
Tarifa për konsumatorë familjare (tarifat e njehsuara përfaqësojnë familjet me 4 anëtarë)	840 Lek tarife e njehsuar; 31 Lek/meter kub	30 Lek/meter kub	28 Lek/meter kub; rreth 840 Lek tarife e njehsuar	30 Lek/meter kub; rreth 620 Lek tarife e njehsuar	32 Lek/meter kub	240 Lek tarife e njehsuar	Rreth 550 Lek tarife e njehsuar	18 Lek/meter kub; rreth 600 Lek
Niveli i mbledhjeve (%)	60	40	67	60	98.83	60	50	60
Humbjet e ujit (%)	68	55	55	60	10	55–60	60	60
Kushtet e sistemit të kanalizimeve	Sh. i keq, disa investime nepermjet PUKB	Sh. i keq, disa investime nepermjet PUKB	Sh. i keq, disa investime nepermjet PUKB	Sh. i keq, disa investime nepermjet PUKB	Sh. i keq, fonde janë dhënë, projekti nuk është zbatuar akoma	Sh. i keq, mungojnë investimet	Sh. i keq, përmirësimi i sistemit filloi në 2003 nga projekti PHARE	Sh. i keq, mungojnë investimet
Oret e furnizimit me ujë*	1.5	4.5	13	4	24	2.4	7.5	1.3
Te ardhurat mujore të familjeve	39,139	60,292	46,644	74,127	50,023	58,716	66,555	29,964
Përqindja e popullsisë që ka lidhje uji	88	85	62	92.4	100	100	100	96.3
Përqindja e popullsisë që ka lidhje në kanalizime	69	86.3	36.7	64.6	95	76.5	87.8	76.8

\* Oret e furnizimit me ujë të paraqitura këtu janë mesatarja për dimrin dhe verën, sic edhe është paraqitur në kapitullin Gjetje dhe Analiza.

Burimi: Pyetësor për familjarët, dhe të dhëna cilësore nga puna në terren për Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit të Ujit në Shqipëri, Dhjetor 2003-Janar 2004

## GJETJE DHE ANALIZA

Me meposhte paraqitet nje pershkrim i detajuar i perceptimeve te konsumatoreve per te dy modelet e menaxhimit dhe nje analize e (a) ndikimeve te reformes ne sektorin e ujit dhe (b) ceshtjeve institucionale dhe pengesave ne reforme.

### **Analiza e Ndikimeve**

#### *Rritja e tarifave*

*Palet kryesore te interesuara* - Tarifat jane te rendesishme per shkak te nderlikimeve qe ato sjellin per te dy palet, ndermarrjet dhe konsumatoret. Nderkohe qe ndermarrjet e ujit perpiqen te rrisin tarifat per te mbuluar kostot, konsumatoret jane ata qe mbartin pasojat. Palet kryesore te interesuara ne tarife jane ERRU, pushtetet vendore, NU, OP, te gjitha kategorite e konsumatoreve (vecanerisht grupet e prekshme) dhe bizneset.

Nje ceshtje institucionale kryesore qe del ne pah, eshte qendrimi i ERRU mbas ndryshimit te rolit dhe pergjegjesive. Me shume pak perjashtime, shumica e specialisteve te intervistuar ne pushtetet vendore dhe ne ndermarrjet e ujit thone se pushteti vendor eshte ne nje pozicion me te pershtatshem persa i perket percaktimit te tarifave dhe eshte me pergjegjes ndaj konsumatoreve dhe ndermarrjeve te ujit. Sfida me e madhe per NU mendohet te jete vendosja e tarifave ne rastet kur asetet e ndermarrjeve te ujit i perkasin me shume se nje njesie te pushtetit vendor sic eshte rasti i Durrësit.

*Ceshtjet kryesore qe kane te bejne me sistemin aktual te faturimit* - Menyra me e perhapur e faturimit per shtate nga qytetet e studiuara bazohet ne tarifen e njehsuar. NU e Korces eshte e vetmja ndermarrje ne vend, faturimi i se ciles eshte plotesisht i bazuar mbi konsumin e matur. Shumica e specialisteve te NU ne shtate qytetet e studiuara (perjashto Korcen) thone se sistemi aktual i faturimit nxit abuzime te medha me ujin dhe si pasoje nuk lejon te mbulohet kostoja e plote e prodhimit.

Kompjuterizimi eshte nje ceshtje tjeter e rendesishme per shumicen e specialisteve, megjithese te dhenat cilesore nga diskutimet ne grupe fokusi nxjerrin ne pah se nje fature e kompjuterizuar nuk do te thote asgje, ne rast se nuk shoqerohet nga permiresimi i sherbimeve. Ndonese konsumatoret e Korces dhe te Durrësit marrin nje fature te kompjuterizuar te detajuar, vetem konsumatoret e Korces e konsiderojne faturen e kompjuterizuar si nje permiresim.

*Emergjenca per instalimin e plote te matesave.* Nje nga objektivat e reformes ne sektorin e ujit eshte vendosja universale e matesave te ujit per te ndaluar abuzimet, si dhe per te arritur menaxhimin e kerkeses gje qe ka ndikime te thella mbi konservimin e ujit dhe menaxhimin e qendrueshme te ujit. Logjika per kete mase te parashikuar ne SKUK eshte mbeshtetur edhe nga diskutimet ne grupet e fokusit ne Korce, ku pjesemarrësit konfirmuan se me t'u instaluar matesat njerezit filluan ta kursejne ujin dhe ta perdorin me kursim per perdorim te brendshem te familjes.

The dhenat sasiore te marra nga PF mbeshthesin kete fakt. Shumica e pjesemarresve u pergjigjen se ngritja e tarifave nuk ka ndikuar mbi konsumin e ujit si rrjedhoje e mungeses se matesave. Gjetja e mesiperme konfirmon gjetjen e studimit pilot AVNS, i cili ve ne dukje se instalimi i matesave konsiderohet si nje faktor thelbesor per nje sistem te drejte te tarifave, bazuar mbi konsumin aktual.

Nje konsumator ne Lezhe shprehet: “Kur nuk kishim matesa mund te ngriheshe ne mes te nates dhe te gjeje te gjitha dritat ndezuar. Po sapo u instaluan metrat situata ndryshoi. Per kete arsye mendoj se menyra me e mire per te shmangur abuzimin me ujin eshte instalimi i matesave. Ata jane te domosdoshem.”

Vendosja universale e matesave eshte nje ceshtje perparore, e cila do te ndikojte mbi menyren ne te cilen familjet do te perballojne tarifat e ngritura. Kjo mase do te jete vecanerisht pozitive per grupet e prekshme, sic jane te varferit dhe pensionistet. Kjo deklarate ilustron prej njerit nga diskutimet e grupit te fokusit ne Keneten e Durrës: “Ne mund ta paguajme tarifen e ujit sic eshte tani, neqoftese ne kemi matesa per te kontrolluar konsumin e ujit.” Kostoja e instalimit te matesave, eshte nje problem i madh, sic edhe eshte ilustruar ne nje nga diskutimet e grupit te fokusit ne Durrës me pjesemarres (qe jane relativisht ne gjendje te mire ekonomike) te cilet jane perfshire ne programin e matesave te PREFU. Nje nga pjesemarresit ne grupet e fokusit u shpreh: “Kur u instaluan matesat e ujit, asnjeri nuk na tha se ne duhej te paguanim 90 dollare amerikane per matesat. Une e di qe cmimi mesatar per nje mates eshte 2,500 Lek, dhe jo 90 dollare amerikane. Une e quaj kete korrupsion. Tani ne paguajme 200 Lek ne muaj shtese ne faturen e ujit.” Kjo gjetje sugjeron dy gjera: (a) kostoja e matesave nuk eshte e perballueshme per familjet e varfera dhe (b) instalimi i matesave duhet te ishte bere pas nje fushate informimi. Ne Sarande jane ndeshur disa raste ku matesat e instaluar nga ndermarrja e ujit ne konsumatore te biznesit jane thyer ose jane bere nderhyrje ne to. Si rrjedhoje, rekomandohet te instalohen matesa ne te cilet nuk mund te nderhyhet, te pakten per konsumatore problematike apo zona problematike.

*Nevoja per te permiresuar nivelet e faturimit* - Per shumicen e NU te studiuara, vetem rreth gjysma e ujit te konsumuar aktualisht faturon (Korca eshte nje perjashtim). Faturimi i papershtatshem vjen kryesisht per shkak te rrjedhjeve, abuzimit me ujin dhe mbikonsumit te ujit. Eshte sugjeruar qe ndermarrjet duhet te rifreskojne bazen e te dhenave te konsumatoreve te tyre per te reflektuar numrin real te konsumatoreve dhe te lidhin kontrata me konsumatore ne zonat e reja te banimit ku ata kane lidhje ne rrjet (edhe pse jo ligjerisht). Duhet te permendet se megjithese shumica e specialisteve te NU shprehen se eshte ne interesin e ndermarrjes qe te lidhe kontrata me konsumatore (e paligjshem), nuk jane ndermarre hapa ambicioze ne kete drejtim .

Baza ligjore aktuale per pagesat e TVSH mund te jene baza e ketij problemi. Aktualisht NU e llogarisin TVSH mbi bazen e nivelit te faturimeve, qe do te thote se sa me shume konsumatore faturon, aq me shume TVSH do te faturon. Per kete arsye, rekomandohet qe nivelet e TVSH te bazohen mbi nivelin e mbledhjeve. Megjithate ekziston nje fakt qe duhet marre ne konsiderate; lidhja e kontratave me konsumatore shtese nuk do te nenkuptoje domosdoshmerisht mbledhjen e me shume te ardhurave, vecanerisht ne vendbanimet e reja, ku problemet ekonomike dhe shoqerore jane me te

medha, dhe ku shumica e familjeve nuk kane nje adrese ku mund te dergohet fatura. Kjo na drejton ne nje fushe tjeter te bashkepunimit te mundshem ndermjet NU dhe pushteteve vendore.

*Permiresimi i nivele te mbledhjeve* - Rritja e nivelit te mbledhjeve eshte ndoshta perparësia kryesore e ndermarrjeve te ujit. Njeri nga specialistet e pushtetit vendor u shpreh se shifrat kombetare te mbledhjeve per vitin 2003 ishin 72-75 perqind, nje shifer me e ulet se ajo e parashikuar. Nje perjashtim pozitiv ishte NU e Korces me nje nivel te mbledhjeve prej 99 perqind. Nga ana tjeter te dhenat e marra nga NU vendore treguan se shifrat e niveleve te mbledhjeve ishin aktualisht me te ulta. Nga pikepamja e specialisteve, ngurrimi i klienteve per te paguar dhe mungesa e masave detyruese jane arsyt kryesore perqjegjese per nivelin e ulet te mbledhjeve.

*Nevoja per te permiresuar formen e detyrimit* - Nje numer i ngjashem personash qe u anketuan ne te dyja grupet e qyteteve (pothuajse 75 perqind e personave qe u anketuan ne qytetet MP dhe MSH<sup>6</sup>) u pergjigjen “po” kur u pyeten nese ndermarrja duhet te permiresoje formen e detyrimit.

Nje konsumator qe jeton ne vendbanimet e reja ne Lezhe shprehet: “Tekniket e ndermarrjes erdhen njehere per te nderprere lidhjet. Me pas ne i vendosem lidhjet serish. Pas kesaj ndermarrja na ofroi kontrata, po ne ende nuk paguajme.”

Nje numer me i larte njerezish ne qytetet MP krahasuar me qytetet MSH raportuan se nuk kishin paguar faturat rregullisht per shkak te mungeses se detyrimit. NU besojne se te vetem, ata nuk mund te jene te suksesshem ne

permiresimin e detyrimit, dhe se pjesemarrja aktive e autoriteteve vendore eshte e domosdoshme.

Sic tregohet edhe me poshte ne Figuren 2, nje numer i perafert personash te anketuar (rreth 24 perqind) ne te dy tipet e qyteteve, ato MP dhe MSH u shprehen se menyra me e mire per te permiresuar detyrimin ishte vendosja e gjobave per ata qe paguajne me vonese. Nderprerja e furnizimit me uje per ata qe nuk paguajne dhe dergimi me poste i kujtesave tek klientet fajtoje jane mundesia e dyte dhe e trete per te dyja llojet e qyteteve. Nje ndryshim del ne pah, qe ka te beje me fushaten e ndergjegjesimit, ku 15 perqind e personave te anketuar nga qytetet MP, krahasuar me 8 perqind te personave te anketuar ne qytetet MSH mendojne se nje metode e tille eshte e domosdoshme per te permiresuar detyrimin.


Duhet te theksohet gjithashtu se, megjithese nje numer pothuajse i njejte i pjesemarrësve u shprehen se nderprerja e furnizimit eshte nje menyre efikase per te denuar ata qe nuk paguajne, te dhenat cilesore nga intervistat me specialiste dhe diskutimet me grupet e fokusit, treguan se kjo metode nuk ka funksionuar. Njeri prej personave qe u pergjigjen e ilustron kete gje. Per me teper, me shume se 70 perqind e personave te anketuar, mendojne se masat e detyrimit duhet te drejtohen

Nje konsumator qe jeton ne vendbanimet e reja ne Lezhe shprehet: “Tekniket e ndermarrjes erdhen njehere per te nderprere lidhjet. Me pas ne i vendosem lidhjet serish. Pas kesaj ndermarrja na ofroi kontrata, po ne nuk

<sup>6</sup> Per te dhena specifike per qytetet shih Shtojca 8, Tabela 3.

drejt konsumatoreve te biznesit, te cilet shikohen si nje kategori qe perdor me shume uje se te tjeret dhe paguan me pak.

**Figura 2. Mendimi i Familjareve mbi Menyren me te Mire per te Permiresuar Detyrimin**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Edhe specialistet e ndermarrjeve te ujit u shprehen se bizneset ishin zakonisht klientet me problematike dhe per kete arsye NU kane kerkuar bashkepunimin e policise bashkiake. Institucionet publike shikohen si grupi i dyte qe duhet te detyrohet te paguaje, dhe kjo sipas 18 perqind e personave te anketuar.

*Mundesia per te paguar dhe deshira per te paguar* - Duke patur parasysh se fatura mujore e ujit perben rreth 1.3 perqind te shpenzimeve te familjeve per te dyja tipet e qyteteve, eshte e qarte se mundesia per te paguar nuk duhet te paraqese problem per shumicen e familjeve. Megjithate, ne shumicen e rasteve fatura e ujit nuk eshte shpenzimi i vetem ne familje per ujin e pijshem. Familjet shpesh blejne uje nga dyqanet, udhetojne per te mberitur tek burimi i ujit, paguajne energji elektrike te perdorur pompat e ujit, blejne rezervuare uji, dhe bejne riparime brenda shtepive per shkak te lageshtires te shkaktuar nga perdorimi gjere i rezervuareve.

Lidhja ndermjet varferise dhe mundesise per te paguar ishte e qarte vecanerisht ne periferite e qyteteve te tilla si, vendbanimi i ri ne Keneten e Durresit. Banoret e Kenetes u shprehen se ata mund ta paguanin faturen e ujit, sic eshte aktualisht, por nje rritje tjeter e tarifave do ta bente te pamundur pagimin. Konsumatorët e bizneseve, jane nje kategori tjeter qe mund te ndikohet negativisht nga rritja e tarifave. Ky shqetesim eshte vecanerisht i madh ne sektorin e sherbimeve dhe ky u ngrit si problem nga pronaret e bizneseve te vogla qe nuk nxjerrin fitime te medha.

Nga ana tjetër, dëshira për të paguar është kryesisht e lidhur me ceshjte të tilla si sjellja ndaj shërbimeve dhe shkalla e kënaqësisë me to. Pyetja qëndron: “Në një kohë kur konsumatorët bëjnë shpenzime shtesë për ujë të pijshëm, përse duhet të paguajmë me shumë për ujë nga rrjeti?” Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit, pranuan se ata janë të gatshëm të paguajmë me shumë, neqoftëse rritet furnizimi me ujë, rritet cilësia e ujit dhe përmirësohet cilësia e shërbimeve. Studimi pilot AVNS, doli në të njëjtat përfundime për sa i përket kësaj çështjeje.

Të dhënat gjithashtu sugjerojnë se rritja e tarifave pa një përmirësim të cilësisë së shërbimit, nuk do të mirëpritet nga konsumatorët dhe mund të shkaktojë pakënaqësi. Kjo deklaratë ilustron me tej nga diskutimet në grupet e fokusit në Durres, ku shumica e pjesëmarrësve u shprehën se rritja e tarifës u shoqërua me premtime për përmirësime të ndjeshme në furnizimin me ujë por kjo nuk u materializua.

**Tabela 3. Arsye të Raportuara për Mospagimin e Faturave të Ujit**

		Qytetet MP (%)	Qytetet MSH (%)
1	Uji duhet të jetë falas	21	1.6
2	Mungesa e mjeteve financiare	25.8	30.6
3	Pakënaqësia ndaj shërbimeve	21	17.7
4	Nuk kemi marrë fatura	4.8	12.9
5	Në duhet të presim në rradhë me orë të tëra	1.6	1.6
6	Orare të papërshtatshme të zyrave të shitjes	1.6	0
7	Nuk ka detyrim	11.3	0
8	Të tjera	12.9	35.6

Burimi: Pyetesor për Familjarët mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit të Ujit në Shqipëri, Dhjetor 2003-Janar 2004

Sic tregon edhe Tabela 3, “pakënaqësia me shërbimet” është arsyeja e dytë me e përmendur për mospagimin e faturës. (Kutia përmbi ilustron këtë pikë). Shumica e të anketuarve nën kategorinë “të tjera” u shprehën (a) “në jemi të lidhur me rrjetin, por nuk kemi kontratë me nëndermarrjen”; (b) në jetojmë jashtë shtetit”; dhe (c) nuk ka ujë.”

Një konsumator nga Lushnja shprehet: “Nëse do të kishim ujë qoftë dhe një orë në ditë, atëherë do t’i paguanim faturat. Pse duhet të paguajmë kur nuk kemi fare ujë?”

Tabela 3 tregon se mentaliteti se “uji duhet të jetë pa pagesë” është një mendësi që ndan dy tipet e qyteteve. Shifrat më të larta në qytetet MP mund të reflektojnë shembuj të familjeve të anketuara (qytetet MP janë ndikuar me shumë nga migracioni i brendshëm). Shumica e njerezve që janë vendosur në periferitë e qytetit, kanë ardhur nga zona ku uji gjendet në natyrë, pa pagesë dhe për këtë arsye konsiderohet si një dhuratë e

perendise. Ka mundesi qe nje arsye kryesore per ndryshimet e vena re eshte qe konsumatorët nuk e shikojne ujin si nje mall per te cilin duhet paguar. Ky fakt nenkupton se OP ne bashkepunim me stafin e NU dhe pushtetet vendore, duhen te bejne kujdes te madh per te rritur ndergjegjesimin e klienteve ne keto zona ne lidhje me pagesat.

Eksperienat e meparshme ne vendet e tjera ne zhvillim, kane treguar se perfshirja e sektorit te shoqerise civile ne fushatat e ngritjes se ndergjegjesimit ka dhene rezultate pozitive, e matur kjo nga niveli i permiresuar i mbledhjeve, ruajtja e ujit e keshtu me rradhe. Per kete arsye sugjerohet te nxitet perfshirja e shoqerise civile edhe ne Shqiperi.

Nje konsumator nga Korça ankohet: “Familja ime paguan rreth 1,300 Lek ne muaj. Kjo eshte nje shifer e larte.” Nga ana tjetër gra nga Këneta shprehen: “Jemi te gatshem te bejme nje kontribut financiar nese eshte e nevojshme, nese NU do te sjelle ujin ne shtepite tona.”

*Nevoja per te rritur tarifat -* Te gjithë specialistet e intervistuar rane dakort se tarifa aktuale e ujit nuk mbulon koston e sherbimeve, dhe nje rritje tjetër<sup>7</sup> e tarifave te ujit dhe kanalizime eshte e nevojshme. OP ne kater qytetet MP konfirmojne kete


deklarate dhe shtojne se rritja e tarifave eshte e pashmangshme per te mbuluar koston e operimit dhe te menaxhimit<sup>8</sup> dhe per te terhequr investitorët. Nga kjo pikepamje rritja e tarifave duhet te shoqerohet me trajnimin e punonjesve vendore te NU, ne menyre qe te adoptohet nje forme veprimi qe eshte me e prirur ndaj biznesit. Kjo ekperience ka provuar te jete shume e suksesshme ne Korce. Per kete ceshtje, nenkryetari i bashkise se Lezhës tha: “Nese NU po punon nen kosto, ne duhet ta rrisim tarifen e ujit. Ne fillim do te jete pak e rende, por eshte nje hap qe duhet ndermarre.” Megjithate, shumica e specialisteve thone se rritja do te jete graduale, duke patur parasysh mundesine e konsumatoreve per te paguar.

Specialistet e Vlores shprehen mendime te ndryshme persa i perket tarifave. Nderkohe drejtori i NU u shpreh: “Qellimi im nuk eshte te rrise tarifat, por te rrise nivelin e mbledhjeve, pasi nje nivel optimal i mbledhjeve me tarifen aktuale do t'i jape mundesi ndermarrjes te mbuloje koston e administrimit dhe te menaxhimit”. Autoritetet bashkiake te Vlores e shprehen hapur qendrimin e tyre, per te rritur tarifen e ujit, menjehere pasi ata ta kene mundesi ta rrisin ate. Ky studim tregon se rritje te metejshme te tarifave zakonisht nuk priten me entuziazem.

<sup>7</sup> Kater NU nen menaxhim privat aktualisht kane tarifa me te larta te ujit, krahasuar me kater qytetet me menaxhim shtetëror. Per me teper tarifat per qytetet MP priten te rriten edhe me shume. Korca nuk mund te krahasohet direkt, pasi percaktimi i tarifave ne Korce bazohet mbi konsumin e matur, duke patur keshtu nje cmim per meter kub per sasine qe konsumohet.

<sup>8</sup> Pervec NU se Korces, asnje nga NU e qyteteve te tjera nuk e mbulojne koston e punes dhe te menaxhimit me tarifat aktuale dhe nivelin e mbledhjeve.

**Figura 3. Përqindja e Konsumatoreve me Kontrate të Cilët nuk janë Pagues të Rregullt**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Sic edhe tregohet ne Figuren 3, numri me i madh i mospaguesve perfshin familjet tejet te varfere. Shifrat e pagesave te parregullta bien, nderkohe qe niveli i varferise ulet. Duhet te theksohet se ne pergjithesi nuk ekzistojne anketa te besueshme te cilat masin mundesine e konsumatoreve dhe deshiren e tyre per te paguar. Per kete arsye sugjerohet ne kuadrin e decentralizimit dhe te ligjit te liberalizimit te tarifave te ujit, qe pushtetet vendore te bejne anketime dhe diskutime ne grupe fokusi me te gjitha kategorite e konsumatoreve, duke perfshire banore nga vendbanimet e reja, per te marre vendime te mire-informuara.

#### *Aksesi ne Sherbimet e Ujit dhe Kanalizimeve*

*Palet kryesore te interesuara* - Cilesia e sherbimeve eshte mundesisht nje nga menytrat me te mira per te matur ndikimin qe reforma ka mbi konsumatoret. Palet kryesore te interesuara, per sa i perket ketyre kanaleve te transmetimit jane qeveria shqiptare, MRRTT, komuniteti donator, ndermarrjet e ujit, pushtetet vendore dhe klientet (te cilet do te jene dhe perfituesit kryesore). Personeli vendor i NU ka tendencen t'i fryje shifrat e cilesise dhe lidhjeve aktuale, krahasuar me te dhenat e marra nga diskutimet ne grupet e fokusit dhe PF. Nje ceshtje tjeter shqetesuese eshte vartesia nga furnizimi me energji elektrike per nxjerrjen e ujit, gje qe e rrit koston e prodhimit.

*Nevoja per te zgjeruar mbulimin nga rrjeti* - Tabela 2 tregon përqindjet e familjeve qe kane lidhje uji dhe sherbime te kanalizimeve. Te dhenat sasiore nga PF tregojne se rreth 82 perqind e te anketuarve ne 4 qytetet MP dhe rreth 99 perqind e te

anketuarve ne kater qytetet MSH raportojne se kane lidhje uji, te ligjshme apo te paligjshme.

**Tabela 4. Nivelet Aktuale te Lidhjes se Ujit dhe te Sherbimeve te Kanalizimeve**

		<b>Lidhja e ujit (%)</b>	<b>Lidhja ne kanalizime (%)</b>	<b>Rezervuare septik (%)</b>
1	Durrës	88	69	18
2	Lezha	62	36.7	62.5
3	Fier	85	86.3	13.9
4	Saranda	92.4	64.6	35
5	Lushnja	96.3	77.8	9.9
6	Vlora	100	87.8	11
7	Gjirokastrë	100	76.5	36.3
8	Korça	100	95	5

Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Sic edhe tregohet ne Tabelen 4, nje nga ndryshimet e medha ndermjet dy tipeve te qyteteve eshte lidhja e sherbimeve te ujit. Numri me i larte i popullsise qe jeton jashte zones se mbuluar, mund te shpjegoje perqindjen me te larte te njerezve ne qytetet MP pa lidhje ne rrjetin e ujit dhe te kanalizimeve. Ne te njejten kohe, investime te pjesshme ne rrjetin e ujit ne keto qytete nuk mund te mbulojne kerkesen ne rritje per sherbime. Nga ana tjetere, qytetet nen menaxhim shteteror e kane ndjere ndikimin e migracionit ne nje shkalle me te ulet. Perseri, situata ne Korce eshte e ndryshme pasi investimi kapital ne rrjet ka mundesuar NU te mbuloje te gjithe klientet.

Sistemi i papershtatshem i mbulimit nga rrjeti i furnizimit me uje i ka detyruar njerezit te gjejne zgjidhje alternative. Per shembull, lidhjet e paligjshme jane forma me e perhapur e mekanizmit te perballimit te problemit. Per shkak te mungeses se mirembajtjes dhe sigurise, eshte e lehte te nderhyhet ne tubacionet kryesore me ndihmen e nje tekniku te ndermarrjes, nje miku, ose vete personat mund te nderhyjne. Perqindja e njerezve qe kane nje apo me shume lidhje te jashteligjshme eshte me e larte ne qytetet MP (shih Tabelen 16 ne Shtojcen 8). Mekanizmi i dyle perballues me i perhapur eshte hapja e puseve ne oborre.

Nje konsumator nga Lushnja: “Ne kemi hapur puse; ujin e marrim prej andej. Puset jane rreth 10 metra te thelle. Ngandonjehere ujerat e zeza depertojne neper toke dhe si rezultat perzihen me ujin. Duhet te germojme shume thelle nese duam te gjejme uje me cilesi [te paster], por kostoja eshte shume e larte.”

Megjithate, hapja e puseve nuk eshte nje fenomen qe ndodh vetem me familjaret. Nje numer hotelesh ne zonen e plazhit te Durresit perdorin puse per t’iu pergjigjur kerkesave gjate sezonit te veres. Lidhjet e

paligjshme dhe puset jane zakonisht individuale. Megjithate, ne disa raste, dy apo me

shume familje bashkohen per te hapur puse te perbashketa. Te dhenat sasiore tregojne se perqindja e lidhjeve te jashteligjshme eshte vecanerisht e larte ne kater qytetet MP, ku perqindja e popullsise qe jeton ne periferi eshte e larte.

Zgjidhja e trete alternative me e perhapur eshte blerja e ujit. Kjo situatë mbizoteron vecanerisht ne Lushnje, ku lidhja ne rrjetin e ujit ka qene plotesisht e papranueshme per vite te tera dhe lagje te tera furnizohen me uje nepermjet autoboteve [makina me uje]. Rreth 80 perqind e te anketuarve nga Lushnja thone se ata e blejne ujin qe perdorin per te pire apo per te gatuar. Nga ana tjeter ka qytete si Saranda apo Durresi ku fenomeni i “makinave te ujit” eshte i perhapur gjate sezonit te veres kur furnizimi me uje eshte i paket. Ekziston nje lidhje ndermjet lidhjes ne rrjetin e ujit dhe varferise ne qytetet MP, ku perqindja e familjeve tejet te varfera qe kane lidhje ne rrjetin e ujit eshte 72 perqind. Per me teper numri i lidhjeve te jashteligjshme eshte vecanerisht i larte ndermjet shtresave tejet te varfera, dhe kjo perqindje ulet ne menyre drastike ndersa kalohet drejt shtresave ne gjendje relativisht te mire ekonomike (shih Tabelen 17 ne Shtojcen 8)

Te gjithë mekanizmat e perballimit, te permendur me larte sjellin pasoja vecanerisht per mjedisin. Lidhjet e jashteligjshme te pa kontrolluara dhe pusët mbartin pasoja negative per menaxhimin e qendrueshem te ujit. Nxjerrja ne sasi te medha e ujit nga toka ka ndikime negative mbi ujin e nentokes, erozionin dhe keshtu me rradhe. Menaxhimi i qendrueshem i ujit eshte nje nga perpresite qe reforma po perpiqet te trajtojë. Nje nga masat e parashikuara ne SKUK eshte shkeputja e nderhyrjeve te jashteligjshme ne tubacionet e ujit. Megjithate, nje mase e tille pritet te ndeshe kundershimitin e atyre paleve qe ndikohen ne menyre te drejtperdrejte, te tilla si familjet, lavazhet e makinave, dhe keshtu me rradhe. Deri tani forma me e perhapur e kundershimitit ka qene mosmarrja parasysh e autoritetit dhe rilidhja ne rrjet. Sic edhe eshte diskutuar ne kapitullin e meparshem ky eshte nje fakt i njohur gjeresisht nga specialistet e NU, te cilet kane dale ne konkluzionet se eshte ne interesin e tyre qe te lidhin kontrata me perdoruesit e jashteligjshem dhe t’i transformojne ata ne perdorues te ligjshem qe paguajne per sherbimet. Ne kete pike del nevoja per te permiresuar mekanizmat detyrues duke siguruar bashkepunimin me pushtetet vendore, shoqerine civile si dhe rritjen e shkalles se ndergjegjesimit.

Situata e sistemit te kanalizimeve nga ana tjeter eshte e ngjashme per te tete qytetet e studiuara. Investimet dhe mirembajtja ne sektorin e kanalizimeve kane munguar plotesisht, dhe ne shume qytete kushtet e sistemit te kanalizimeve jane shume me te papershtatshme se sa ne sistemin e ujit. Tabela 5 jep nje pasqyre te qarte te kushteve te lidhjeve ne sherbimet e kanalizimeve, duke paraqitur nje shifer shume me te ulet se lidhja ne rrjetin e ujit. Te dhenat e anketimit tregojne se 64.5 perqind e familjeve ne kater qytetet MP jane te lidhura ne sistemin e kanalizimeve, nderkohe qe kjo shifer eshte me e larte per qytetet MSH, 84.3 perqind. Ndikimi i migracionit te brendshem ne qytetet MP shpjegon perseri kete mosperputhje.

Rezervuaret septike jane zgjidhja me e perhapur per perballimin e pershtatshem te problemeve me ujrë e zeza. Shifrat jane 31.6 perqind per qytetet MP dhe 15.5 perqind per qytetet MSH. Te dhenat cilesore tregojne se perqindja relativisht e larte e familjeve

ne Gjirokaster qe kane rezervuare septike vjen si pasoje e rrjetit te kanalizimeve tejet te rrenuar.

Perdorimi i gjere i rezervuareve septike ne vetvete permban pasoja te tilla si ndotja e ujrave te nendheshem si pasoje e depertimit<sup>9</sup> ne toke, perhapja e semundjeve si pasoje e pastrimit te parregullt dhe keshtu me rradhe. Aktualisht nje hap i nevojshem perpara per NU do te ishte marrja persiper e pergjegjesise per te pastruar rezervuaret septike. Kjo kerkon blerjen e pajisjeve te nevojshme. Ne te njejten kohe, rrjeti i rrenuar i kanalizimeve dhe mungesa e vendeve te trajtimit te ujrave te zeza, pervec te tjerave mund te shkaktojne ndotje, te demtojne ujrat e lumenjve dhe deteve dhe te jene nje burim semundjesh. Kjo mund te kete edhe pasoja ekonomike ne industri dhe peshkim per qytetet bregdetare.

SKUK nje nevojten emergjente per nderhyrje ne sektor, por nje nderhyrje e tille ne shkalle te gjere mund te kerkoje investime te medha, te cilat qeveria shqiptare nuk mund t'i perballoje. Eshte e nje rendesie teper te vecante qe komuniteti donator te luaje nje rol aktiv duke dhene fonde te nevojshme dhe ekspertize.

*Nevoja per te permiresuar besueshmerine e furnizimit me uje dhe cilesine e lidhjes [ne rrjet] - Studimi yne mbeshtet edhe nga gjetjet nga burime te tjera, te cilat kane treguar se lidhja ne rrjet nuk do te thote se lidhja me sherbimet eshte e pershtatshme<sup>10</sup>. Ne te vertete, te dhenat nga anketimet tregojne se nga te gjitha familjet qe raportojne te kene lidhje ne sherbimet e ujit, furnizim te perditshem me uje kane vetem 45.4 perqind e personave te anketuar ne kater qytetet MP dhe 60.3 perqind e personave te anketuar ne qytetet MSH. Familjet qe nuk perfitojne furnizim te perditshem raportojne se numri mesatar i diteve me furnizim me uje gjate veres ishte 17 dite per muaj ne qytetet MP dhe 14 dite ne muaj ne qytetet MSH; furnizimi ne dimer ishte 25 dite ne muaj per grupin e pare te qyteteve dhe rreth 20 dite per grupin e dyte. Ne kater qytetet MP nga te gjitha familjet qe raportuan se kishin lidhje uji, 32 perqind kane me pak se 2 ore furnizim me uje gjate veres. Kjo perqindje ulet disi ne 25.7 perqind gjate dimrit. (per te dhena specifike mbi qytetet, ditet dhe sasine e oreve te furnizimit, shih Tabelat 8, 9, 10 dhe 11 ne Shtojcen 8).*

Figura 4 tregon qartazi se furnizimi me uje ne shtate nga tete qytetet e studiuara eshte fare i papershtatshem dhe sistemi aktual nuk ofron nje standart te pranueshem te furnizimit. Korca eshte nje perjashtim pasi ofron 24 ore furnizim me uje me presion. Situata me e rende paraqitet ne Durres, Lushnje dhe Gjirokaster. Ditet dheoret e furnizimit me uje ndryshojne ne vartesi te sezonit. Furnizimi me i paket gjate veres mund te shpjegohet me nje faktor kryesor: uji i pijshem perdoret per vaditje ne kete


Nje konsumator nga Saranda shprehet: "Njerezit ujin kopshtet, dhe e perdorin ate [ujin e pijshem] per larje makinash dhe per bagetine."

<sup>9</sup> Shumica e rezervuareve septike jane thjeshte gropa primitive te hapura ne toke, pavaresisht nga lloji i dheut, dhe nuk perputhen me asnje parameter te higjenes.

<sup>10</sup> Hermine De Soto dhe te tjere. 2002. "Poverty in Albania: A Qualitative Assessment." The World Bank. Washington D.C.

menyre sasia e ujit qe vjen ne qytet eshte me a paket. Per me teper abuzimet me ujin jane te rendomta ne te gjitha qytetet e studiuara me perjashtim te Korces.

**Figura 4. Sasia e Oreve Mesatare te Furnizimit me Uje per Qytetet (Furnizimi ne Vere kundrejt Dimrit)**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Numri i diteve me furnizim uji per kater qytetet MP eshte gjithashtu disi i lidhur me varferine, ku numri i diteve me furnizim uji rritet me 2 kur niveli i varferise leviz nga shtresat tejet te varfera ne shtresat relativisht ne gjendje te mire. Oret me furnizim uji ne dite paraqesin njefare lidhjeje me nivelin e varferise, por vetem per kater qytetet nen menaxhimin e shtetit, ku shtresat tejet te varfera kane rreth dy ore me pak furnizim me uje ne dite se shtresat e varfera, ndersa keta te fundit kane respektivisht rreth dy ore me pak uje se shtresat jo te varfera.

Njerezit ne pergjithesi e perballojne furnizimin e papershtatshem me uje me disa menyra: (a) duke blere rezervuare uji, (b) duke blere pompa uji. (c ) duke blere uje, dhe (d) duke vendosur lidhje shtese. Te dhenat sasiore treguan se perqindja e familjeve qe raportojne se kane rezervuare uji eshte rreth 70 perqind per qytetet MP dhe 57 perqind per qytetet MSH. (Aktualisht rezervuaret e ujit nuk jane te nevojshem ne Korce). Arsyeya me shpesh e permendur per rezervuaret e ujit eshte pamundesia e sistemit per te siguruar uje 24 ore ne dite. Per me teper, te dhenat mesatare per numrin e oreve te furnizimit me uje nxjerrin ne pah nje tendence qe ka te beje me kapacitetin e rezervuareve - sa me e shkurter te jete periodha e furnizimit me uje ne dite, aq me i madh eshte kapaciteti i rezervuarit.

Te dhenat cilesore nga diskutimet ne grupet e fokusit tregojne se njerezit jane te pakenaqr me presionin e ujit, ku katet e larta jane me te zhgenjyerit. Konsumatoret ne



shtate qytetet e studiuara mbeshteten gjeresisht tek pompat e ujit. Per me teper, edhe furnizimi me uje ndikohet nga nderprerjet e energjise elektrike. Keto nderprerje jane raportuar si nje problem i madh ne diskutimet ne grupet e fokusit ne Durres. Familjet me te varfera nga ana tjetere, raportojne se kane mundesi te kufizuara per te blere pompa uji dhe rezervuare. Te dhenat cilesore tregojne se shumica e familjeve te varfera perdorin kova ose govata per te mbajtur uje, ne vend qe te instalojne rezervuare dhe pompa. (Te dhenat e detajuara mbi prezencen e rezervuareve te ujit dhe pompave dhe menyres se si ato jane te lidhura me varferine mund te gjenden ne Tabelat 24 dhe 25 ne Shtojcen 8).

Te dhenat cilesore nga diskutimet ne grupet e fokusit tregojne se mendimi i konsumatoreve per cilesine aktuale te lidhjeve ka te beje me mendimin se furnizimi aktual me uje nuk do te permiresohet per sa kohe qe ekzistojne individe te caktuar te cilet mund te perfitojne nga bizneset e shitjes se rezervuareve te ujit dhe pompave. Mekanizmat e lartpermendur te perballimit kane ndikime financiare si dhe ndikime ne mjedis. Shpenzimet e larta per blerjen e rezervuareve te ujit, pompave te ujit, detyrimi financiar i larte ne faturat e energjise elektrike per funksionimin e pompave te ujit, shpenzimet per riparime ne shtepi per shkak te lageshtires dhe zhurmes nga funksionimi i pompave, jane disa nga efektet anesore te mekanizmit te perballimit. Rezervuaret e ujit gjithashtu favorizojne abuzimet me ujin. Valvulat e sigurise shpesh prishen dhe nuk eshte e pazakonte te shohesh uje qe rrjedh nga rezervuaret gjate oreve te furnizimit.

Nje nga masat e parashikuara ne SKUK per permiresimin e cilesise se furnizimit me uje ka te beje me nderprerjen e lidhjeve te paligjshme te lavazheve te makinave ose kompanive te ndertimit. Keto tipe biznesesh zakonisht konsumojne sasira te medha uji pa iu dashur te paguajne. Deri tani perpjekjet e NU per te nderprere keto lidhje kane qene te pasuksesshme. NU mendojne se nuk kane mbeshtetjen e duhur ligjore per te zbatuar ligjin. Duke patur parasysh situaten e furnizimit me uje ne Shqiperi dhe mundesine e qeverise per te investuar, mund te dilet ne konkluzionin se ka ende shume pune per te bere qe keto efekte anesore te zhduken. Megjithate, masat e parashikuara ne reforme, se bashku me pjesemarrjen aktive te donatoreve pritet te ulin ndikimet negative mbi jeten dhe mjetet financiare te njerezve si dhe mbi mjedisin.

*Nevoja per te permiresuar cilesine e ujit* - Shumica e specialisteve vendore e konsiderojne cilesine e ujit pergjithesisht brenda parametrave te pranueshem dhe si rrjedhoje te pijshem. Megjithate, te dhenat e marra nga pjesemarrjesit e grupeve te fokusit dhe PF nuk e mbeshtetin kete mendim. Nderkohe qe te gjithet specialistet u shprehen se

Nje grua nga Fieri pershkruan ujin: “Vjen ere te keqe, ka ngjyre jo normale – ngjyre ndryshku. Edhe bagetia do te ngordhe po pine kete uje.”

ata pinin uje nga rubineti, vetem 56.7 perqind e te anketuarve nga qytetet MP dhe 57.7 perqind e te anketuarve nga qytetet MSH pinin uje nga rubineti. Rreth 53 perqind e familjeve nga kater qytetet MP dhe 38.3 perqind e familjeve ne qytetet MSH u shprehen se uji ishte i papaster per t’u pire. Keto verejtje mbeshteteshin ndonjehere nga raste kur

uji i pijshem perzihej me kanalizimet, apo kishte ngjyre dhe ere te keqe. Keto te dhena jane te ngjashme per te gjithë te anketuarit, pervec familjeve te Korces te cilet raportuan se nuk kishin pothuajse asnje problem qe kishte te bente me cilesine e ujit, pervec nivelit te larte te klorines ne disa raste (kjo verejtje, gjithesesi, nuk mbeshtetet nga testet e laboratorit). Diskutimet ne grupet e fokusit treguan se qytetet me problematike ishin Durresi, Lushnja, Gjirokastra dhe pjeserisht Fieri.

Disa nga menytrat se si njerezit perballojne cilesine e papershtatshme te ujit jane (a) blerja e ujit, (b) zjerja e ujit, dhe (c ) ngrirja e ujit. Megjithate ashtu sikurse e theksuan edhe shume njerez, nuk eshte aspak ekonomike te blesh uje te pijshem vazhdimisht, vecanerisht ne vere, kur konsumi rritet. Po nuk eshte praktike as te ziesh apo te ngrish ujin perpara se ta pish. Si pasoje megjithese njerezit nuk jane te kenaqur me cilesine e ujit, pjesemarresit raportuan pirje uji nga rubinetit pasi kjo eshte ekonomike dhe me e pershtatshme.

Shumica e specialisteve te NU kane theksuar se eshte e nevojshme te ndryshohet teknologjia e klorinimit, e cila eshte shume e vjeter dhe nuk eshte e pershtatshme per standartet e sotme te cilesise. Uji testohet cdo dite nga njesia e kujdesit te shendetit paresor, e cila dorezon nje raport mujor tek NU. Megjithate ne rast ndotje te ujit, dergohet nje njoftim i menjehershëm ne NU dhe ne kete rast si NU ashtu edhe njesia e kujdesit te shendetit paresor jane pergjegjese per te informuar konsumatorët. Zakonisht kjo behet nepermjet medias vendore. Duhet te vihet ne dukje se edhe kur ka patur raste te dukshme te ndotjes te ujit eshte treguar ngurrim nga ana e bashkive dhe autoriteteve te NU per ta pranuar.

Te dhenat cilesore kane nxjerre ne pah nje marredhenie ndermjet varferise, lidhjeve [ne rrjet] dhe vendbanimit, keshtu qe ne pergjithesi shtresat e varfera kane lidhje te nje cilesie me te ulet dhe lidhjet permiresohen kur levizet drejt zonave me prane qendres se qytetit. Kutia 1, e marre nga kater diskutime te ndryshme ne grupet e fokusit ne Durres, ilustron kete marredhenie. Durresi eshte ndoshta rasti me i nderlikuar nder te gjitha qytetet e studiuara. Kutia 5.1 ilustron se si lidhja ne rrjet ka te beje me vendbanimin dhe terheq vemendjen mbi rendesine e lidhjes ne rrjet me zhvillimin e turizmit. Lidhja ndermjet lidhjes ne rrjet dhe varferise eshte theksuar nga krahasimi i diskutimeve ne grupin e pare dhe te katert te fokusit. Grupi i katert mund te konsiderohet si i perbere nga shtresat tejet te varfera ose shtresat e varfera, kurse grupi i pare mund te konsiderohet si i perbere nga shtresat relativisht ne gjendje te mire ekonomike.

### **KUTIA 1. Marredhenia ndermjet aksesit, vendbanimit dhe varferise**

Nje banor nga [qendra] e qytetit shprehet: “Ne lagjen time, furnizohemi me uje per rreth 2 ore ne dite, dhe kjo ndodh ne mbremje. Ne perdorim pompa uji per te rritur presionin ne menyre qe te mbushim rezervuaret e ujit. Mund te them se ne lagjen time investimi tregoi nje permiresim te vogel te furnizimit me uje. Gjate sezoneve te kaluara te veres ne furnizoheshim me uje vetem hera-heres. Gjate kesaj vere, me kemi uje cdo mbremje. Megjithate nuk ka nje orar te caktuar. Rezervuaret e ujit jane shpetimi yne.”

Nje banor i periferise urbane shprehet: “Ne kemi uje nga rrjeti nje here ne dite per dy ore. Ardhja e ujit nuk ka nje orar te caktuar, keshtu qe nese ne nuk jemi ne shtepi [gjate kohes qe vjen uji] ne mbetemi pa uje, dhe rezervuaret e ujit nuk mbushen. Edhe gjate oreve te furnizimit me uje nuk ka presion, dhe ne na duhet te perdorim pompen e ujit. Disa prej nesh shkojne ne rezervuaret e ujit per te marre uje; por, policia na kerconon po ta bejme kete. Ne fillim te veres, ne furnizoheshim me uje vetem nje here ne jave, edhe atehere na duhej te mbartnim uje, pasi nuk na vinte brenda ne shtepi. Me vone ne filluam te kishim uje cdo dy dite. Shpesh here nuk ka energji elektrike gjate oreve te furnizimit me uje dhe ne nuk e perdorim dot pompat e ujit, pa te cilen uji nuk mund te ngjitet ne rezervuar.

Nje banor i zones se bregdetit shprehet: “Ne na vjen furnizimi me uje nje here ne kater dite. Edhe kur ka uje, ai ka nje ere shume te keqe dhe eshte me ngjyre. Perpara, une e zieja ujin, por tani as e zjera nuk ia heq aren e keqe. Ne nje rast nuk na erdhi uji per 25 dite; e bleme ujin nga makinat e ujit. Une e blej ujin per te gatuar dhe per te pire. Konsumoj rreth 5 litra uji nga shishet ne dite. Edhe gjate oreve te furnizimit, nuk ka me shume se 45 minuta uje ne shtepite tona. Edhe ate pak uje qe kemi, e marrim fale pompave; pa pompa nuk do kishim uje fare. Eshte e qarte se po nuk patem energji elektrike pompat nuk punojne dhe si pasoje nuk kemi as uje. Furnizimi me uje nuk ka nje orar te caktuar. Ka patur raste kur na ka ardhur uji edhe ne oren 3 te nates”

Nje banor i zones se Kenetes (vendbanim i ri) shprehet: “Ne nuk kemi furnizim me uje. Ne e marrim ujin me karroca dore nga komshinjte dhe nuk kemi lidhje ne rrjetin e furnizimit me uje. Disa prej komshinjte na lene te marrim uje, te tjere nuk na lene. Edhe komshinjte tane te cilet jane te lidhur ne rrjet kane gjetur menyra per te marre uje ne menyre te paligjshme. Ngandonjehere policia vjen dhe i shkeput keto lidhje. Pastaj ne ngelemi pa uje fare. Burrat tane jane tere ditën jashte shtepise per te kerkuar pune te rastit, keshtu qe neve na duhet ta mbartim ujin vete. Te gjitha ne qe jemi ketu sot vuajme nga nje lloj semundje veshkash apo nje tjeter dhe kjo per shkak se mbajme pesha te renda cdo dite. Ne na duhet te ecim 40 minuta per te mberitur tek burimi i ujit.

*Mbeshtetja per shtresat e varfera nepermjet sherbimeve te ndihmes*

*Palet kryesore te interesuara* - Ceshtja e subvencioneve perfshin disa pale te interesuara, te tilla si Qeveria Shqiptare (QSh), Pushtetet Vendore, NU dhe OP per kater qytetet MP dhe perfituesit kryesore (qe jane familjet e prekshme). Ndhima ne sherbime nepermjet ofrimit te 20 litrave ne dite pa pagese per person eshte skema e subvencioneve e propozuar nga QSH si pjese e reformes per lehtesimin e varferise. Njera nga ceshtjet kryesore me kete kanal transmetimi eshte identifikimi i drejte i familjeve qe kane nevoje. Per me teper duhet te arrihet nje ekuilibër ndermjet trajtimit shoqeror te problemit nga ana e pushtetit vendor dhe menyres tregtare te perdorur nga NU.

*Shperndarja e varferise ne qytetet e studiuara* - Sic edhe tregohet ne Tabelen 5, perceptimet e te anketuarve mbi situaten e tyre ekonomike jane te ngjashme per te dyja grupet e qyteteve<sup>11</sup>.

**Tabela 5. Shperndarja e Varferise per te dy Grupet e Qyteteve**

		<b>Qytetet MP (%)</b>	<b>Qytetet MSH(%)</b>
1	Shtresat tejet te varfera	18	18.8
2	Shtresat e varfera	34.5	37
3	Shtresat jo te varfera	47.2	42
4	Shtresat relativisht te pasura	0.3	2.2
<b>5</b>	<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Burime te tjera te te dhenave qe kane te bejne me varferine, te tilla si shifrat e punesimit dhe te papunesise dhe numri i familjeve qe perfitojne ndihme sociale nga shteti nga te dyja grupet e qyteteve jane zakonisht me te ulta se ato te paraqitura ne table. Rreth 2 perqind e te anketuarve nga kater qytetet MP dhe rreth 3.6 perqind e te anketuarve nga kater qytetet MSH kane raportuar te kene perfituar nga kjo lloj ndihme, ne nje kohe kur niveli i papunesise paraqitej rreth 6 perqind per te anketuarit ne qytetet MP dhe rreth 16 perqind per te anketuarit ne qytetet MSH. Nga ana tjeter perqindja e familjeve te cilat perdorin metoden e listes<sup>12</sup> per te blere, eshte rreth 13.8 perqind per qytetet MP dhe 5.6 perqind per qytetet MSH<sup>13</sup>. Mosperputhja ndermjet burime te ndryshme te te dhenave mund te shpjegohet nga dy faktore kryesore: (a) nje numer i shtresave tejet te varfera nuk jane perfshire ne planin e ndihmes sociale per shkak te te metave ne procesin e perzgjedhjes ose per shkak se ata nuk i permbushin kriteret e

<sup>11</sup> Tabela 21 ne Shtojcen 8 jep te dhena specifike per cdo qytet ne lidhje me shperndarjen e varferise

<sup>12</sup> I referohet nje liste te mbajtur nga shitesat (zakonisht te dyqaneve te bulmetit) qe permban emrat e personave dhe shumen qe duhen te paguajne kur nuk kane mundesi te paguajne ne momentin e blerjes. Parate paguhen zakonisht kur burimet behen te mundshme.

<sup>13</sup> Tabela 26 ne Shtojcen 8 paraqet te dhena specifike per qytetet ne lidhje me kete ceshtje

perzgjedhjes dhe (b) njerezit kane tendencen qe te nenvleresojne situaten e tyre financiare, keshtu qe ata raportojne te jene ne gjendje te varfer edhe kur nuk jane.

*Nevoja per te permiresuar mekanizmin e identifikimit te perfituesve* - Diskutimi i mesiperm ngre pyetjen: “Cfare duhet bere per nje identifikim te sakte te familjeve qe kane nevojte?” Deri tani specialistet dhe pjesemarresit ne grupet e fokusit kane shprehur mosbesimin e tyre per sistemin, duke permendur raste te njerezve qe vijne per te marre ndihmen me makina personale, Mercedes Benz, nderkohe qe familje te tjera qe kane nevojte jane lene jashte sistemit. Kjo konfirmohet edhe nga te dhenat sasiore, te cilat vene ne dukje se 75 perqind a familjeve qe perdorin listen nuk marrin ndihme ekonomike nga shteti. Kjo sjell nevojten per ngritjen e nje mekanizmi me efikas per identifikimin e familjeve qe duhet te perfitojne. Duke qene se pergjegjesia e identifikimit te familjeve ne nevojte i takon bashkise, kjo e fundit duhet te ndermarre nismen per te gjetur metoda te tjera identifikimi. Ne kete drejtim pushteti vendor mund te kerkoje ndihme nga shoqeria civile per anketa socialo-ekonomike, te cilat jane vetem nje nga metodat e shumta qe mund te perdoren nga palet e interesuara. Per me teper verifikime ne vend dhe venia e gjobave per nepunes te korruptuar te shtetit mund te jene nje forme e mire per te korrigjuar problemin.

*Zgjedhja e politikës së drejte për subvencionet* - Te dhenat e mbledhura nga burime te ndryshme tregojne se tarifat e propozuara te ndihmes mund te mos jene metoda me e mire per te lehtesuar pasojat negative mbi grupet e prekshme. Figura 5 paraqet mendimin e konsumatoreve ne kater qytetet MP ne lidhje me tarifen.

Figura 5 tregon qarte se mendimi i konsumatoreve ne lidhje me tarifen e ndihmes eshte i njejte per te tre grupet e shtresave te varfera<sup>14</sup>. Te dhenat e anketimit tregojne se megjithese me shume se 50 perqind e te anketuarve kane nje mendim pozitiv per sa i perket kesaj forme te subvencionit, nje numer i madh i familjeve te anketuara jane shprehur se tarifa e ndihmes nuk do te kete asnje ndikim. Duke marre parasysh te dy tipet e te dhenave sasiore dhe cilesore, ne mund te arrijme ne konkluzionin se qytetaret ne kater qytetet MP nuk ishin te qarte ne lidhje me tarifen e ndihmes dhe shumica e tyre nuk kishin degjuar asnjehere per te.

Kur u pyeten per tarifen e propozuar te ndihmes si nje forme subvencioni, jo te gjithë specialistet e intervistuar rane dakort se kjo eshte menyra me e mire. Ata qe e mbeshteten ishin kryesisht autoritetet e NU, per mendimin e te cileve kjo forme subvencioni nuk le vend per abuzime, sikunder mund te jete rasti i subvencionit te ndihmes ne para. Nga ana tjeter autoritetet e pushtetit vendor, vecanerisht specialistet ne Njesine e Ndhimes Sociale ne bashki, u shprehen ne lidhje me menyra te tjera, te tilla si subvencionet e drejtperdrejta duke rritur shumen e ndihmes ekonomike nga shteti, si nje forme me e pershtatshme. Autoritetet e NU ne Fier shtuan se shuma e rritur e subvencioneve duhet te shkoje direkt tek NU. Drejtori i NU se Korces u shpreh “Ndermarrja duhet te punoje ne baze te rikuperimit te kostos. [Ndermarrja] Nuk mund te ndaloje e te mendoje per filantropi.” Si pasoje, gjetja e ekuilibrit te drejte ndermjet nje

---


<sup>14</sup> Grupi relativisht ne gjendje te mire nuk eshte perfshire ne kete analize pasi eshte teper i vogel.

menyre te menduari mbi bazen e kostos efektive dhe te menduarit shoqeror mund te jete e veshtire.

Nje nga problemet qe mendohet te sjelle tarifa e ndihmes eshte varesia nga instalimi i matesave. Zbatimi i tarifes se ndihmes nenkupton qe kjo forme e subvencionit duhet te filloje te funksionoj ne momentin e rritjes se tarifave, gje e cila do te thote se matesat duhet te jene instaluar deri ne momentin qe tarifat rriten. Nje rekomandim i mundshem eshte zbatimi i tarifes se njehsuar qe eshte me e ulet se tarifa per pjesen tjeter te popullsisë.

Nje banor i periferise urbane te Fierit shpreh opinionin e tij: "Tarifa ndihme nuk mund te zbatohet sepse nuk jane instaluar matesa. Si do t'i masni 20 litrat?"

**Figura 5. Mendimi i Grupe te Varfera te Ndryshme mbi Tarifen e Ndhimes (ne qytetet MP)**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Nje tjetër fakt që ka të bëjë me tarifën e propozuar prej 20 litrash për person në ditë u ngrit nga njëri prej diskutimeve në grupet e fokusit në Fier, ku njëri nga pjesëmarrësit u shpreh: “Tarifa e ndihmes nuk ka kuptim. 20 litra janë sa një përdorim i rezervuarit të banjës.” Ndoshta forma të tjera të subvencionit për familjet në nevojë mund të merren parasysh, si përsëmbull zbatimi i tarifave bllok. Pasi të jenë instaluar matësat, NU mund të vendosin tarifa bllok. Në këtë mënyrë vendoset një tarifë minimum për konsumin ditor të ujit deri në një nivel të caktuar dhe nëse sasia kalohet ky “bllok”, tarifa “për meter kub” është e barabartë me tarifën e zbatuar për pjesën tjetër të popullsisë.

*Ndikimi i reformës në sektorin e ujit mbi punësimin*

Mënyrat më të cilat reforma në sektorin e ujit pritet të ndikojë mbi punësimin është specifike për secilin qytet për shkak të veçorive të tregut vendor të punës, i cili do të kanalizojë mënyrën më të cilën do të ndihet ndikimi. Për qytetet si Durrës, Sarandë, Vlorë dhe Lezhë, turizmi do të jetë fusha që do të ndikohet më shumë nga reforma. Të gjithë specialistët e intervistuar mendojnë se reforma do t’i bëjë këto qytete më tërheqës, gjë që do të sjellë rritjen e numrit të turistëve që do të vizitojnë këto zona. Kjo do të ndikojë pozitivisht mbi bizneset dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë në rritjen e fondeve bashkiake si pasojë e mbledhjes së taksave<sup>15</sup>. Si pasojë, një ndikim jodirekt por i thellë i reformës mund të jetë forcimi financiar i pushtetit vendor.

<sup>15</sup> Rritja e fondeve të bashkive nëpërmjet këtij burimi pritet të realizohet në momentin e parë pasi kompetencat respektive të jenë transferuar tek PV


Pervec turizmit, nje fushe tjeter qe do te ndikohet nga reforma eshte perpunimi i ushqimeve, i cili eshte nje nga aktivitetet ekonomike kryesore per qytetet Lushnje, Fier, dhe Gjirokaster. Nje sasi me e madhe uji dhe nje uje i nje cilesie me te larte patjeter qe do te ndikojne dukshem ne efikasitetin dhe eficencen ne industrine e perpunimit te ushqimeve. Ne Korce nga ana tjeter operojne ndermarrjet me te medha te birres ne vend, si dhe fabrika te prodhimeve te pijeve joalkolike dhe qe te dyja keto biznese varen nga cilesia dhe furnizimi me uje te pijshem.

Nje tjeter fushe ku reforma mund te ndikojte eshte ajo e sektorit te sherbimeve, i cili eshte drejtperdrejt i varur nga furnizimi me uje. Te dhenat cilesore nga intervistat me biznese ne sektorin e sherbimeve, kryesisht bare dhe restorante, nxjerrin ne pah se pronaret e bizneseve presin qe bizneset e tyre te rriten pasi situata e furnizimit me uje te permiresohet.

Nje ndikim tjeter i permiresimit te furnizimit me uje ka te beje me punesimin e grave. Pjesemarresit e grupeve te fokusit ne Durres dhe Gjirokaster shpjeguan se grate duhet te qendrojne zakonisht ne shtepi per te pritur qe te vije uji dhe te bejne punet e shtepise. Shpresohet se nese furnizimi me uje permiresohet, grate do te jene me pak te varura nga uji dhe do te fillojne te kerkojne pune jashte shtepise.

Ndikimet mbi punesimin varen kryesisht (por jo kretesisht) nga situata e furnizimit me uje. Rendesia e sherbimeve te pershtatshme te kanalizimeve mendohet te jete faktori tjeter qe do te ndikojte mbi industrine e turizmit, dhe qe paraqet ndikime te qarta mbi te ardhmen e zhvillimit ekonomik te qyteteve bregdetare. Per me teper, mungesa e vendeve te trajtimit [te ujrave te zeza] konsiderohet si nje problem kryesor per zhvillimin e industrise se turizmit. Aktualisht, kanalizimet derdhen direkt ne lumenj apo dete dhe per kete arsye jane ndotes te medhej. Sic edhe u shprehen disa nga specialistet, mungesa e infrastruktures se pershtatshme ka shkaktuar uljen e numrit te turisteve shqiptare te cilet i benin pushimet ne qytete si Durresi dhe Saranda, por tani i kalojne ato ne vende te huaja.

## **Figura 6. Mendimi i Familjeve mbi Ndikimin e Reformes ne Punesim**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Figura 6 portretizon mendimin e te anketuarve mbi marredheniet ndermjet ketyre dy faktoreve. Shpesh here eshte e veshtire qe njerezit te kuptojne se si permiresimet ne sherbimet e ujit dhe te kanalizimeve ndikojne ne punesim.

Duhet te permendet se ka nje tendence nga ana e specialisteve te intervistuar qe t'i trajtojne marredheniet qe lindin ndermjet permiresimit te furnizimit me uje dhe punesimit si afat-shkurtera. Shpesh punesimi konsiderohet si ndikim pozitiv vetem gjate fazes se punes per permiresimin e furnizimit, gjate se ciles punesohen me shume njerez per ndertimin dhe riaftesimin e rrjetit.


#### *Kanale te tjera te ndikimit te reformes*

*Shendeti* - Shumica e pjesemarresve ne grupet e fokusit u shprehen se ata e shikonin cilesine e ujit te lidhur drejtperdrejt me ceshtjet e shendetit. Raste te semundjeve te shkaktuara nga uji, kryesisht diarrea, jane raportuar ne Gjirokaster dhe Durres, dhe femijet jane shtruar ne spital. Rrjeti aktual tejet i vjeteruar dhe i rrenuar i furnizimit me uje dhe kanalizimeve eshte pergjegjes per keto semundje ne Gjirokaster, nderkohe qe furnizimi i papershtatshem me uje per shkak te lidhjeve te paligjshme eshte arsyeja kryesore ne Durres. Diskutimi ne grupin e fokusit ne Kenete, nje vendbanim i ri ne Durres me nje popullsi prej 30,000 banorsh, nxorri ne pah prezencen e nje numri semundjesh qe vijne ose jane te lidhura me mungesen e ujit te rrjedhshem dhe infrastruktures se kanalizimeve. Komplikacione shendeti u raportuan nder femijet dhe grate, te cilat perkeqesohen me shume si pasoje e mungeses se mjeteve financiare per te patur trajtimin e duhur mjekesor apo ilace per te kuruar semundjet.

Ne Korce nuk jane raportuar raste te semundjeve te shkaktuara nga uji. Pjesemarresit ne grupet e fokusit u shprehen se me ndertimin e rrjetit te ri, keto semundje jane ulur shume. Raste te semundjeve nuk u raportuan as nga pjesemarresit e grupit te fokusit ne Lushnje dhe Fier, “megjithese uji eshte fare i papijshem” - u shprehen ata. Nje tjeter semundje qe ka te beje me ujin eshte reumatizma. Nje numer pjesemarresish te grupeve te fokusit raportuan se shtepite e tyre kishin shume lageshtire per shkak te rezervuareve te prishur te ujit.

Pjesemarresit ne grupet e fokusit ne te gjitha qytetet e studiuara ishin te shqetesuar per semundjet qe mund te shkaktoheshin nga rrjeti tejet i vjeteruar i kanalizimeve. Kanalizimet shikohen si burim semundjesh akoma edhe me te rrezikshme se uji i nje cilesie te ulet dhe te papershtatshme. Ujrat e zeza qe rrjedhin pergjate rrugeve jane nje “fenomen i perditshem” per shumicen e pjesemarresve te grupeve te fokusit ne te tete qytetet e studiuara.

**Figura 7. Mendimi i Familjeve mbi Ndikimin e Reformes ne Shendet**



Burimi: Pyetesor per Familjaret mbi Decentralizimin AVNS dhe Privatizimin e Sektorit te Ujit ne Shqiperi, Dhjetor 2003-Janar 2004

Duhet te vihet re se, edhe kur rastet e semundjeve qe kane te bejne me ujin kane gene te dukshme, autoritetet vendore kane refuzuar ta pranojne faktin. Intervista me pushtetin vendor, NU vendore dhe njesite vendore te shendetit publik nuk raportuan asnje rast shqetesues. Frika se mos humbasin apo dobesojne marredheniet ndermjet tyre, apo frika se mos informacioni keqperdoret mund t'i beje keta “aktore” te fshehin informacionin. Spitalet nga ana tjeter jane burime me te besueshme se palet e interesuara te mesiperme. Marredhenia e ngushte dhe e vazhdueshme qe ekziston vecanerisht ndermjet NU dhe njesive te perkujdesjes per shendetin mund ta shpjegojne kete gje.

*Toka* - Asete te tjera si toka apo kursimet nuk duket te kene asnje lidhje me reformen ne sektorin e ujit. Vetem drejtori teknik i NU ne Lezhe permendi ndikimet pozitive te permiresimit te furnizimit me uje mbi vleren e tokes. Njera nga arsyet perse as specialistet e as pjesemarresit e grupeve te fokusit nuk e shikojne kete lidhje ndermjet furnizimit te permiresuar me uje dhe vleres se tokes mund te shpjegohet pjeserisht nga koncepti relativisht i ri i “te qenit pronar i tokes” apo “te qenurit pronar i prones private”. Si pasoje eshte e veshtire per ata ta shikojne lidhjet midis dy koncepteve qe perpara nuk kane patur marredhenie te drejtperdrejta.

*Kursimet* - Asnje nga burimet e te dhenave nuk tregon ndonje ndikim te reformes mbi kursimet. Kjo mund te shpjegohet nga fakti se fatura e ujit perben vetem nje fraksion te vogel te shpenzimeve mujore te familjeve. Per me teper, shume familje te varfera apo tejet te varfera mendojne se termi “kursime” eshte i huaj per ta.

## **Palet e Interesuara dhe Ceshtjet Institucionale**

Kapitulli i metodologjise paraqet nje pershkrim te roleve dhe kompetencave te seciles prej paleve te interesuara. Me poshte paraqitet nje analize ne thellesi, e cila ka si qellim te identifikojne problemet qe kane te bejne me palet e interesuara, boshlleqet institucionale dhe problemet qe nderhyjne ne zbatimin e reformes. Konkluzionet e nxjerra nga kjo analize jane trajtuar ne detaje ne kapitullin Konkluzione dhe Rekomandime per Politikate.

### *Palet e interesuara dhe mjedisi i ri institucional*

Te dhenat e marra kane nxjerre ne pah prezencen e dyshimeve, tensioneve, dhe mosmarreshjeve ndermjet paleve te interesuara. NU ende po perpiqen te percaktojne rolin e tyre dhe rolin e aktoreve te tjere. Disa prej ceshjeve te diskutuara ketu kane te bejne vetem me kater qytetet MP.

Shumica e specialisteve te NU kane raportuar se roli i NJMK nuk eshte i qarte per ta. Mendime te tilla si “...perse duhet NJMK te menaxhoje parate tona? Ne i nxjerrim parate, dhe jo NJMK”, ishin te shumta. Sugjerohet qe, NJMK te marre nismen per te organizuar seminare me specialistet vendore si pjese e strategjise se shperndarjes se informacionit dhe ngritjes se kapaciteteve.

Mendimi i ndermarrjeve te ujit per komitetin ekzekutiv ishte i njejte me sjelljen e reflektuar kundrejt NJMK. Megjithese KE eshte formuar per te mbeshtetur NU, keto te fundit jane mosbesuese ndaj KE dhe shprehen mendimin se KE nuk eshte i afte. NU nuk jane te qarta per ekzistencen, funksionin dhe perberjen e KE. Per me teper ndermarrjet mendojne se po merren vendime strategjike per NU pa i angazhuar ato ne kete proces. Ne kete pike, nje fushate informimi dhe komunikimi qe te kete si synim rritjen e transparences dhe nxitjen e bashkepunimit qe eshte i domosdoshem.

Mendimi i pergjithshem per menaxhimin e NU ne te gjitha qytetet e studiuara ishte se Keshilli Mbikqyres nuk ishte nje strukture efektive, dhe nese krahasohej me

bordin e meparshem te ndermarrjes, shume nga specialistet e intervistuar mendonin se ky i fundit ishte me i afte dhe me efektiv. Disa prej specialisteve te NU vendore u shprehen, “Keshilli Mbikqyres as nuk eshte i nevojshem. Marrja e pagave shtese eshte gjithe pergjegjesia e tyre.”

Sipas nje specialisti te qeverise qendrore, NU iu mungon ndergjegjesimi mbi detyrat dhe pergjegjesite e OP sipas kushteve te kontrates. I njejti burim tregon se ka patur ngurim nga ana e personelit te NU per t’u ulur dhe per te lexuar kontraten e menaxhimit, e cila jep nje pasqyre te qarte te roleve respektive dhe pergjegjesive. Per kete arsye, nje program aktiv dhe intensiv komunikimi qe te trajnoje stafin e NU, mendohet te jete menyra me e mire per te rritur ndergjegjesimin.

Specialistet e qeverise qendrore dhe NJMK e pranojne ekzistencen e veshtiresive fillestare ndermjet pushtetit vendor dhe NJMK. Sjellja e NU erdhi kryesisht si rezultat i entuziazmit te tyre fillestar (jorealiste) per operatoret private, gje e cila me pas u pasua nga nje zhgenjim. I njejti ekspert shtoi se marredheniet ndermjet NU dhe OP jane permiresuar ndjeshem. Megjithate, mendimi i specialisteve ne nivel pushteti vendor nuk e mbeshtet faktin se pushteti vendor dhe NU po bashkepunojne. Autoritet vendore nuk i njihnin dhe nuk ishin familjarizuar me rolet dhe pergjegjesite e secilit aktor.

Duke e njohur rolin e rendesishem te pushtetit vendor si nje ofrues i (adhshe) i sherbimeve, operatori privat ne kater qytetet MP, shprehu interesin e tij te hapur ne bashkepunimin me pushtet vendore dhe u shpreh se do merrte pjese aktive ne proces.

#### *Ceshtjet kryesore qe kane te bejne me palet e interesuara*

*Njohurite dhe shperndarja e informacionit* - Mungesa e dhenies se informacionit apo shkembimit te tij duket te jene faktoret qe fshihet pas mendimeve te gabuara dhe tensioneve ndermjet paleve te ndryshme te interesuara. Autoritetet vendore dhe personeli i NU nuk jane gjithmone te mireinformuar mbi vendimet e marra nga qeveria qendror apo kohen kur merren keto vendime, keshtu qe infomacioni nuk behet i njohur ne kohe. Trajtimi i kesaj ceshtjeje mund te jete instrumental ne nje zgjidhje te konfliktit dhe mund te sherbeje si baze per bashkepunim te metejshem ndermjet paleve te interesuara.

*Ushtrimi i te drejtave dhe kompetencave te reja* - Mungesa e nismes nga pushteti vendor dhe mungesa e nxitjes nga qeveria qendrore jane pergjegjese per situaten ne te cilen – pavaresisht nga prezenca e disa mjeteve institucionale - nje statut i ri i bordit per te hartuar marreveshjen e sherbimit me ndermarrjen dhe nje marreveshje projekti me Banken Boterore, ku specifikohen te drejtat dhe detyrimet e bashkive te perfshira ne projekt - kryetaret e bashkive ende nuk po i ushtrojne kompetencat e caktuara per ta nga ligji.

Sjellja e Entit Rregullator te Ujit (ERRU) po mbeshtet kompetencat e reja te deleguara tek pushteti vendor qe kane te bejne me vendosjen e tarifave. Intervista jozytare me specialiste te ERRU kane nxjerre ne pah se ata kundershtojne rolin e ri te PV ne decentralizimin e tarifave.

*Korrupsioni i punonjesve te NU* - Shume prej pjesemarrjesve ne grupet e fokusit ngriten shqetesimet e tyre rreth korrupsionit te disa punonjesve te NU. Shumica u ankuan per pagesat shtese qe keta punonjes iu kerkojne klienteve ne shkembim te sherbimeve te tyre. Kjo ka sjelle mosbesim tek ndermarrjet e ujit. Per me teper, shumica e konsumatoreve ne vendbanimet e reja u shprehen se punonjesit e NU i ndihmonin ata ne vendosjen e lidhjeve te paligjshme perkundrejt nje kompensimi. Njeri nga specialistet e NU i konfirmoi keto akuza, duke thene, “Do te ishte naive nga ana jone te mos pranohet se punonjesit tane ofrojne sherbime personale (te paligjshme) gjate dites se tyre te punes. Nuk ka kuptim te mendosh se ata do te punojne tete ore ne dite, cdo dite per ate rroge qe ata marrin”. Ne menyre qe te perballohet kjo, disa nga kompanite aksionere po perpiqen te rrisin pagesat e punonjesve, te cilet nga ana e tyre priten te rrisin perkushtimin e tyre.

*Bashkimi i ndermarrjeve te ujit dhe te kanalizimeve* - Megjithate perpjekjet e vazhdueshme nuk eshte perfunduar ne shkalle kombetare bashkimi midis ndermarrjeve te ujit dhe te kanalizimeve. Shtate nga tete qytetet e studiuara e kane perfunduar, me perjashtim te Vlores. Njeri nga specialistet e qeverise qendrore, shpjegoi se ka dy arsye per kete vonese. E para ka te beje me klimen politike ne vend, e cila do te thote se qeveria qendrore dhe pushteti vendor duhet te perfaqesojne te njejten force politike. Arsyja e dyte, ndoshta edhe me e rendesishme, eshte se sherbimi i kanalizimeve eshte plotesisht i varur nga subvencionet e shtetit dhe si pasoje eshte nje burim i mire fondesh per bashkite. Per kete arsye qeveria qendrore beson se vonesat po shkaktohen ne menyre te qellimshme nga pushteti vendor.

*Politizimi i reformes dhe nevoja per te ruajtur memorjen institucionale* - Njeri nga rreziqet me te cilin po perballlet reforma eshte politizimi (kjo do te thote vartesia e reformes nga klima politike e vendit). “Politika po e ndot ujin,” tha nje specialist i NU. Organet vendim-marrese jane aktore politike te cilet kane interesat e tyre te shpalluar apo te pa shpallura. Kjo do te thote se zbatimi i reformes varet nga deshira politike e disa aktoreve per te ecur perpara, dhe nga mundesia e institucioneve per te ruajtur memorjen e tyre institucionale ne kohe ndryshimesh. Si pasoje, per te siguruar suksesin e reformes, eshte e nje rendesie te vecante te gjenden mjetet e duhura per te minimizuar ndikimin qe politizimi mund te kete mbi reformen dhe te ruhet ne menyre te domosdoshme memorja institucionale.

*Nevoja per te permiresuar kuadrin ligjor* - Dy nga shqetesimet kryesore te ngritura nga specialistet e PV dhe NU, ne te gjitha qytetet e perfshira ne studim ishin kuadri ligjor i paplote dhe baza ligjore e papershtatshme.

Futja [paraqitja] e tarifes se kanalizimeve nga te gjitha NU qe nuk eshte kryer ende, si ne rastin e Vlores, u konsiderua nje hap i domosdoshem prej disa nga specialisteve ne te dy nivelet e pushtetit qendor dhe vendor. Nje tjetër ndryshim i domosdoshem qe duhet marre ne konsiderate eshte percaktimi i tarifes per kanalizimet si nje detyrim ekzekutiv, megjithate kjo nuk garanton zbatimin. Specialistet ne NU vendore raportuan se pagesa ligjore per denoncimin ligjor te debitoreve mund te jete me e larte se

shuma qe ata nuk kane paguar<sup>16</sup>. Nje mekanizem detyrues, i cili mund te zbatohet ne menyre specifike mbi institucionet publike, eshte qe te percaktohet fatura e ujit si nje ze me vete ne buxhet, keshtu qe shuma qe duhet paguar eshte e paracaktuar dhe parate shkojne direkt ne llogarine bankare te NU. Ndryshimi i bazes ligjore per pagesat e TVSH, nga ajo me faturim ne ate me mbledhje mendohet te jete nje nxitje, qe ndermarrjet e ujit te rrisin nivelet e faturimit pa patur frike nga kundra-ndikimet.

---

<sup>16</sup> Ndjekja ligjore e debitoreve te KESH ka qene e suksesshme; megjithate KESH dhe NU nuk krahasohen dot me njera tjetren per shkak te ndryshimeve te dukshme qe kane.

# KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PER POLITIKAT

Ky studim ka nxjerre ne pah disa ngjashmeri si edhe disa ndryshime ndermjet qyteteve me menaxhim privat dhe atyre me menaxhim shteteror.

## Ngjashmerite

Disa ngjashmeri qe jane vene re ne te dyja grypet e qyteteve perfshijne:

- Perqindja e njerezve pa lidhje uji eshte me e ulet se perqindja e njerezve pa akses ne kanalizime. Kjo mosperputhje mund te shpjegohet nga rendesia relative e secilit prej sherbimeve per mbijetesen. Furnizimi me uje eshte me jetesor per njerezit per shkak se nuk mund te zevendesohet me dicka tjeter.
- Te dy grupet e qyteteve kane ngjashmeri ne sistemin e faturimit; ku tarifat e njehsuara jane forma me dominuese e faturimit.
- Pushteti vendor po punon ne nje mjedis institucional te ri i cili perbehet nga pale te reja te interesuara, dhe kerkon bashkepunim e koordinim, si dhe njohuri me te mira mbi rolet e seciles prej paleve te interesuara.
- Autoritetet vendore po perballen me tre ceshtje kryesore: (a) mungesa e ekspertizes se duhur per ceshtjet administrative dhe te menaxhimit te ndermarrjeve; (b) prekshmeria e ndermarrjeve te ujit nga procesi politik, ku disa prej administratoreve te rinj mund te jene te emeruar politike dhe jo specialiste teknike; dhe (c) humbja e memorjes institucionale si rezultat e arsyes se lartpermendur.
- Shkembimi i informacionit dhe komunikimi ndermjet paleve te ndryshme te interesuar perbejne nje ceshtje te rendesishme per suksesin e reformes. Ky problem thellohet edhe me shume per shkak te roleve te reja dhe mjedisit te ri ne te cilin punojne palet e interesuara.
- Konsumatoret ne te dyja tipet e qyteteve nuk mund ta thone fjalen e tyre ne procesin e vendim-marrjes.
- Shumica e zyrave te NU nuk kane asnje seksion te marredhenieve me klientet, keshtu ankesat nga individe dhe grupe deshtojne.

## Ndryshimet

Duhet te theksohet se perfitimi nga nje investim prej shume milionash e ka bere qytetin e Korces (qytet i menaxhuar nga shteti) te dale me vete nga qytetet e tjera qe jane studiuar ne pothuajse cdo aspekt qe ka te beje me sherbimet e ujit dhe kanalizimeve.

Disa nga ndryshimet kryesore te vena re ndermjet dy grupeve te qyteteve dhe ndermjet dy tipeve te ndryshme te menaxhimit te ndermarrjeve perfshijne:

- Qytetet me ndermarrje te menaxhuara privatisht kane patur nje rritje te shpejte urbane, qe ka rezultuar ne vendbanime te medha, lidhje me te pakta te ujit dhe te kanalizimeve persa i perket siperfaqes se mbulimit, nje numer me i larte lidhjesh te paligjshme dhe te rezervuareve septike, tarifa me te larta dhe kenaqje e nje shkalle me te ulet me sherbimet.
- Persa i perket cilesise se lidhjeve - besueshmeria, kohezgjatja e furnizimit dhe presioni - qytetet MP praqiten ne nje gjendje disi me te mire (Korca perjashtohet nga analiza). (Disa nga qytetet MP perfitojne nga PREFU, i cili ka permiresuar lidhjen e matur nga rritja ne oret e furnizimit.)
- Pakenaqesia e klienteve nga tarifat e rritura ne kater qytetet MP ka ardhur per shkak te faktit se fatura me e larte e ujit krahasuar me faturen e ujit ne qytetet me menaxhim shteteror, nuk mendohet se justifikohet nga sherbimi.
- OP ne kater qytetet MP ka nje strategji te qarte per te mbuluar kostot e operimit dhe menaxhimit dhe ka percaktuar tregues mates, gje qe nuk ka ndodhur ne tre qytetet me menaxhim shteteror (perseri, Korca perjashtohet).
- Shtresat me standarte te ulta jetese ne kater qytetet MP priten te kene perparesi mbi te tjeret ne qytetet e menaxhuar nga shtetit per shkak te nje skeme subvencionuese te propozuar 20 litra per person ne dite pa pagese, megjithese disa specialiste dhe kliente nuk e shikojne kete forme subvencioni si optimale.
- Struktura institucionale eshte e ndryshme per te dyja tipet e qyteteve. Kater qytetet e menaxhuara privatisht kane dy struktura me teper - Komitetin Ekzekutiv dhe NJMK, te cilet jane pergjegjes per vendosjen e perparesive, duke marre vendime te rendesishme dhe duke hartuar planet e veprimit. Nga ana tjeter kater qytetet me menaxhim shteteror varen nga qeveria qendrore per miratimin e vendimeve kryesore.
- Nje nga objektivat e OP per kater qytetet MP eshte te hartoje dhe zbatoje nje program strategjik te zhvillimit te burimeve njerezore, nje hap kryesor qe momentalisht mungon ne qytetet me menaxhim shteteror.
- Ristrukturimi i kater NU te menaxhuara privatisht do te sjelle humbjen e vendit te punes per disa punonjes; kjo suate pritet te pasohet nga kundershime dhe moskenaqesi.

*Rekomandime per politikat*

Reforma ne sektorin e ujit ne Shqiperi eshte nje pune sfiduese per shkak te kompleksitetit te reformes dhe situates aktuale socialo-ekonomike ne Shqiperi. Qellimi perfundimtar i reformes nuk eshte vetem te ofroje sherbime te nje cilesise me te larte per me shume kliente por edhe te nxise nje menaxhim te qendrueshem te ujit. Ne kete aspekt, ky studim nxjerr ne pah nevojten emergjente per investime ne shkalle te gjere ne kete sektor, nje metode te rikuperimit te kostots per ndermarrjet e ujit, dhe ndikimin e ketyre masave mbi grupe te ndryshme. Nje liste e rekomandimeve te detajuara eshte paraqitur me poshte:

*Strategjia per rritjen e tarifes* - Te gjitha te dhenat te cojne ne konkluzionin se rritja e tarifave duhet te zbatohet vetem pasi konsumatorit te kene fituar besimin se furnizimi eshte permiresuar ne menyre te ndjeshme, mjaftueshem per te justifikuar nje rritje tjeter. Kjo gjetje ka te beje vecanerisht me qytetet MP. Mund te behen anketime te publikut ne kete pike per te matur mundesine dhe deshiren e klienteve per te paguar. Gjeja me e rendesishme qe te mbahet parasysh eshte se kur tarifa te jete rritur, permiresimi i sherbimit duhet te jete i tille qe te minimizojte ose te eliminoje shpenzimet e tjera qe kane te bejne me ujin. Kjo duhet t'u tregohet konsumatoreve nepermjet analizave te kostos dhe perfitimit ne seminare te mbajtuara ne nivele komunitetesh te udhehequra nga punonjesis e NU dhe OP, te ndihmuara nga pushtetet vendore perkatese. Pefshirja e aktoreve te shoqerise civile mund te jete me perfitim ne arritjen e rezultateve te deshiruara.

*Nevoja per te marre ne konsiderate politika alternative te subvencioneve* - Ky studim sugjeron se mund t'i vije ne ndihme marrjes ne konsiderate te formave te tjera te subvencioneve per shtresat e varfera duke patur parasysh se 20 litrat per person ne dite varen nga instalimi i matesave, te cilet nuk jane te mjaftueshem. Forma alternative mund te perfshijne ngritjen e mases se ndihmes ekonomike nga shteti, zbatimin e tarifave ne bllok, apo zbatimin e tarifes se njehsuar me te ulet se ajo normale. Nje identifikim me i mire qe do te perfshije periferite e qyteteve dhe zonat e vendbanimeve te reja eshte i domosdoshem. Bashkepunimi i ngushte ndermjet qeverise vendore, NU dhe shoqerise civile konsiderohet si nje domosdoshmeri ne kete faze.

*Perfaqesimi i konsumatoreve dhe paleve te konsumatoreve* - Megjithese ngritja e paneleve te konsumatoreve eshte parashikuar ne SKUK, nuk jane ndermarre hapa konkrete per te lehtesuar apo nxitur kete pjese te reformes. Mund te mendohet se sa me shpejt te ngrihen keto panele aq me shpejt do te ndryshojte sjellja e konsumatoreve.

*Ristrukturimi institucional* – Ne menyre qe te kryhet restrukturimi institucional, qeveria duhet te percaktojte qarte mekanizmin per te koordinuar dhe integruar aktoret e rrjetit, si ata publike ashtu dhe ata private. Krijimi i nje komitet nder-ministerial per decentralizimin eshte permendur ne SKUK; megjithate, ndikimi i tij nuk eshte ndjere ne realitet. Mund te jete ne interes te te gjitha paleve te interesuara qe te mblidhen dhe te rishikojne te gjitha dokumentat duke perfshire SKUK, te hartojne nje kuader te ri dhe realist per objektivat e parapercaktuara, dhe me pas te vendosin mbi hapat konkrete qe duhet te ndermerren.

Eshte e nevojshme te formulohet nje “reform e buxhetit” e cila duhet te perfshije: (a) nje plan afat-gjate per investime kapitale dhe kostot e operimit dhe menaxhimit, me zera te vecante per cdo vit; (b) subvencione te shtetit per te shlyer borxhet e NU dhe paguar ristrukturimin fillestar organizativ te NU; (c) subvencione te shtetit per personat e perfshire ne programin e ndihmes sociale dhe subvencione per tarifen e ndihmes; (d) fonde te dedikuara per ngritjen e kapaciteteve ne NU; dhe (e) menyra dhe strategji se si do te ulen gradualisht fondet e shtetit. Ne kete drejtim, eshte e rendesishme te rifilloje pergatitja e Programit te Investime Publike (PIP) dhe te integrohet reforma e budgetit si pjese e PIP. Kjo do te mundesoje nje vision strategjik me te mire per investime te ardhshme dhe hartimin e rekomandimeve mbi politikat.

*Formulimi i plan-veprimeve bazuar ne treguesit e matshem te ecurise ne nivel NU* - Plani i veprimeve te qeverise duhet te mbeshtetet nga plane-veprimi ne nivel NU. Sic edhe u rekomandua nga specialestet e MF, (analogjia behet per KESH) per te gjitha NU duhet te behet nje plan veprimi, i cili bazohet mbi tregues te matshem te ecurise (te ngjashem me ato te bere per NU me kontrata menaxhuese nga Banka Boterore (BB).

*Futja e “subvencioneve mbi baze ecurie“* - Subvencionet e shtetit per NU nuk jane te bazuar mbi treguesit e matshem te ecurise. Kjo le vend per parregullsi dhe praktika jo te rregullta. Ne kete drejtim, eshte e nevojshme te percaktohen keta tregues dhe te futet koncepti i “subvencioneve mbi baze ecurie”, i cili do te thote se shuma e subvencioneve qe NU do te perfitoje, do te jene ne funksion te ecurise se tyre.

*Nevoja per te rishikuar bazen ligjore qe ka te beje me TVSH* - Ne sugjerojme nevojten per ndryshim ne bazen ligjore per TVSH, qe do te thote qe TVSH te llogaritet mbi bazen e te ardhurave te mbledhura nga faturimi dhe jo nga niveli i faturimit.

*Formulimi i planeve strategjike per zhvillimin e burimeve njerezore te NU* - Duke patur parasysh kushtet aktuale te NU, del nje nevojte emergjente per formulimin e nje plani strategjik te zhvillimit te burimeve njerezore. OP ne kater qytetet e menaxhuara privatisht e kane hartuar nje plan te tille, dhe eshte e nevojshme qe NU ne qytetet me menaxhim shteteror te adoptojne nje plan te tille.

*Transferimi i aksioneve kundrejt transferimit te aseteteve* - Nje nga sfidat me te medha me te cilat perballtet reforma eshte inventari i aseteteve i sistemit kompleks te ujit. Si do te ndahen asetet e nje sistemi rajonal dhe si do te shperndahen ato ndermjet njesive vendore te ndryshme? A eshte e drejte te shperbehet nje njesi qe funksionon mire? Per kete arsye, sugjerohet nje tip tjeter transferimi - transferimi i aksioneve ne njesite vendore perkatese. Keto aksione mund te shperndahen bazuar mbi vleren e aseteteve.

*Mundesia per privatizimin e pjesshem te NU* - Privatizimi hap-pas-hapi mund te konsiderohet si nje zgjidhje e mundshme per disa nga problemet e NU. Privatizimi i njesive te shitjes mund te jete hapi i pare. Kjo mendohet te permiresoje detyrimin, rritjen e faturimit dhe nivelin e mbledhjeve; dhe per kete arsye do t'i jape nje shtyese realizueshmerise financiare te ndermarrjes.

*Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve ne nivel pushteti vendor* - Intervistat e bera me specialiste ne tete qytetet e studiuara nxorren ne pah se bashkive perkatase jo vetem iu mungon ndergjegjesimi mbi pergjegjesite qe ato do te kene, por ajo qe eshte edhe me e rendesishme, ju mungon ekspertiza per ushtrimin e ketyre pergjegjjesive. Per te edukuar personelin e bashkive rreth rolit te ri qe ata pritet te luajne dhe rreth marredhenieve te reja qe ata duhet te ndertojne me qeverine qendrore dhe aktore te tjere mbi bazen e nje filozofie te re te menaxhimit te sherbimeve te ujit dhe kanalizimeve, do te duhen me shume perpjekje, me shume fonde dhe me shume kohe.

Mundesia e pushtetit vendor per te ecur perpara me reformen, eshte veshtiresuar shume nga mungesa e memorjes institucionale. Ndryshimet ne stafin bashkiak, per shkak te zgjedhjeve vendore, nuk shoqerohen me transferimin e njohurive dhe dokumentave institucionale. Kjo mund te coje ne rezultate te komplikuar per zbatimin e reformes dhe mund te vere ne rrezik suksesin e saj.

*Nevoja per te decentralizuar shperndarjen e informacionit* - Shumica e te dhenave cilesore nga intervistat e detajuara me specialistet ne pushtetet vendore tregojne qarte se pushteti vendor nuk i njeh masat e reja ligjore dhe institucionale qe jane vene brenda kuadrit te reformes ne sektorin e ujit. Si pasoje, pushteti vendor punon me informacion te papershtatshem qe e con ne hamendje jorealiste dhe pozicione te keqduhehequra. Per te arritur decentralizimin e shperndarjes se informacionit, duhet te perdoren mekanizma te tjere te rinj per rritjen e ndergjegjesimit pervec Gazetes Zyrtare, te tilla si diskutime ne tryeza te rrumbullaketa, seminare dhe komunikim i hapur.

*Nevoja per te treguar rastet e praktikave me te mira* - Praktika te mira ekzistojne, Korca eshte rasti konkret. Fatkeqesisht, keto praktika mbeten te panjohura per shumicen e NU ne Shqiperi. Perpara permiresimeve te bera gjate vitit te kaluar, situata e furnizimit me uje ne Korce ishte e ngjashme me situaten aktuale ne qytetet e tjera. Duke pare kete rast, do te jete shume i dobishem organizimi i vizitave te ndersjellta per punonjesit e bashkive te tjera dhe organizimi i seminareve praktike dhe informative me raste te ilustruara.

*Nevoja per te integruar ceshtjet e ujit dhe te kanalizimeve ne nje politike kombetare per mjedisin* - Kushtet e veshtira te rrjetit te furnizimit me uje, lidhjet e paligjshme tek rrjeti i ujit nga individe, hapja e shpeshte e puseve te ujit, jane disa nga shkaqet qe po shkaktojne humbje te ujit ne masa alarmante. Keto humbje mund te vene ne rrezik te madh qendrueshmerine e burimeve te ujit dhe te rezultojne ne nje nevojte urgjente per nje politike kombetare qe ka te beje me menaxhimin e burimeve te ujit. Politikat e ardhshme qe kane te bejne me zhvillimin e sektorit te ujit duhet te bazohen mbi mendimin se uji eshte nje burim i paperseritshem. Per me te per, kushtet e veshtira te rrjetit te kanalizimeve dhe numri i larte i rezervuareve septike jane dy ndotesit kryesore ne mjedis. Kjo eshte nje ceshtje qe kerkon kujdes te vecante per shkak se mund te kete rezultate negative, vecanerisht per qytetet bregdetare.

*Thirrje per partneritet shume-sektorial* - Sherbimet e ujit dhe te kanalizimeve perbejne nje sektor strategjik qe ka nevojte te madhe per investime per te arritur standartet

nderkombetare dhe per te siguruar nje zhvillim te qendrueshem. Per kete arsye ngritja e nje partneriteti ndermjet sektoreve private dhe publike si dhe shoqerise civile duhet te konsiderohet si nje alternative qe mund te ofroje sherbime me kosto efikase nderkohe qe numri i shtresave te varfera qe jetojne ne zona ubane rritet. Eksperienca nderkombetare ne vendet ne zhvillim ka treguar se partneritetet mund te jene te suksesshme, nese te gjitha palet e interesuara arrijne ne nje konsensus<sup>17</sup>.

---

<sup>17</sup> Colin dhe Lockwood. 2002. "Research and Surveys Series: Making Innovation Work Through Partnerships in Water and Sanitation Projects." BPD Water and Sanitation Cluster. London.

## **Kutia 2. Nje Shembull Ilustrues nga Korca**

### **Korça: Nje rast i suksesshem**

Nje kredi prej 23 milion Euro e dhene nga KfW u perdor per te ndertuar nje rrjet te ri te furnizimit me uje ne Korce duke instaluar pajisjet me te avancuara nga ana teknike. Njeri nga faktoret qe beri te mundur suksesin e ketij projekti ishte trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve te personelit vendor te shoqeruar nga nderhyrjet teknike. Kjo sherbeu per te rritur ndergjegjesimin e personelit per efikasitetin dhe eficencen e ndermarrjes dhe marredheniet me klientet. Nje zyre e re e shitjeve u hap ne nje vend te pershtatshem dhe fatura e shkruar me dore u zevendesuara me nje fature te printuar dhe me zera te ndare. Instalimi i matesave ishte nje tjetër hap i rendesishem per rritjen e ndergjegjesimit te konsumatoreve per konservimin e ujit, qe iu dha tyre mundesine qe te kontrollojne konsumin e ujit dhe ta pershtasin ate sipas te ardhurave te familjes. Aktualisht humbjet e ujit ne Korce jane minimale, te ardhurat e ndermarrjes jane optimale dhe konsumatorët jane me te kenaqurit ne krahasim me shtate qytetet e tjera te studiuara.

Sipas drejtorit te NU ne Korces, pika e forte e ketij projekti ishte se kredia pati si synim te ndertonte nje rrjet krejtesisht te ri, duke perfshire shperndarjen dytesore dhe nuk ishte thjeshte nje rikonstruktim i pjesshem i rrjetit. Sic e percakton ai ristrukturimi eshte thjeshte nje “projekt emergjence” dhe nuk mjafton per te plotesuar kerkesat ne rritje te konsumatoreve per furnizim me uje.

Nje gjetje e rendesishme qe doli gjate intervistes me drejtorin teknik te NU ne Korce ka te beje me kapacitetin vendor dhe mendimin ndaj asistences teknike te huaj. Drejtori teknik shpjegoi se: “Ne fillim ne (inxhinjeret dhe tekniket e NU) ishim pak te zhgenjyer dhe te prekur ne seder kur nuk ishim te perfshire direkt ne projekt. Megjithate, kur filloi zbatimi i projektit, ne e kuptuam se nuk kishim kapacitetin e duhur per te perdorur teknologjine e re. Ata (operatorët e huaj) perdoren mjete teknike kaq te sofistikuara dhe modele krejtesisht te reja qe ne as qe i kishim degjuar. Tani ne e kemi ekspertizen dhe mund ta ndajme.”

Shefi i njesise se ndihmes sociale ne bashkine e Korces tha se nje perfitim tjetër nga projekti ka qene nje rritje ne shkallen e punesimit, megjithese ka qene afat-shkurter. Gjate fazes se ndertimit, shume banore vendas u punesuan, kryesisht si punetore krahu. Shumica e ketyre perfituesve ishin kryefamiljare te familjeve qe ishin nen ndihmen sociale te shtetit.